

Skender Mekolli

DHUNA DHE SIGURIA NË SHKOLLA

Raport hulumtimi



Prishtinë, 2015

Skender Mekolli

**DHUNA DHE SIGURIA
NË SHKOLLA**

Raport hulumtimi

Prishtinë, 2015

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Për botuesin

Ismet Potera

Autor

Skender Mekolli

Bashkëpunëtor profesional

Binak Gërguri

Ekipi hulumtues

Skender Mekolli

Binak Gërguri

Arbnesha Mexhuani

Sahare Reçica

Sylejman Sylejmani

Lektor

Mirjeta Gashi

Përgatitja teknike

Leart Mekolli

Përmbajtja

Përmbledhje	6
Hyrje.....	10
KAPITULLI I.....	12
1.DHUNA DHE SIGURIA.....	12
1.1. Paraqitja e problemit	12
1.2. Hulumtimet për dhunën dhe sigurinë në shkolla	15
1.3. Siguria dhe legjislacioni	18
KAPITULLI II	21
2.METODOLOGJIA	21
2.1. Qëllimi dhe objektivat e hulumtimit.....	21
2.2. Metodot	21
2.3. Instrumentet	22
2.4. Popullata dhe mostra	23
2.5. Grumbullimi dhe analiza e të dhënave	24
KAPITULLI III.....	25
3.REZULTATET NGA HULUMTIMI.....	25
3.1. Rezultatet e hulumtimit me mësimdhënës dhe nxënës	25
3.1.1.Trajnimet.....	26
3.1.2.Ligjet, Strategjitë, rregulloret	27
3.1.3.Perceptimi i sigurisë në shkolla	29
3.1.4.Dhuna dhe kërcënimet/rreziqet për nxënësit gjatë udhëtimit për në shkollë.....	30
3.1.5.Koha dhe vendi ku nxënësit ndjehen më të pasigurt.....	30
3.1.6.Format e dhunës, ngacmimit/kërcënimit.....	32

3.1.7. Ushtruesit e dhunës dhe viktimat e dhunës.....	35
3.1.8. Prania e dukurive negative dhe raportimi i tyre nga nxënësit.....	37
3.1.9. Reagimet e dëshmitarit (vëzhguesit) ndaj dhunës.....	39
3.1.10.Reagimet e viktimës.....	40
3.1.11.Qendrimet ndaj dhunës.....	41
3.1.12.Shërbimi profesional.....	43
3.1.13.Bashkëpunimi me prindër	44
3.1.14.Bashkëpunimi me policinë dhe prania e saj në shkollë	45
3.1.15.Çka mundë të bëjnë mësimdhënësit për një shkollë më të sigurt	47
3.1.16.Çka mundë të bëjnë nxënësit për një shkollë më të sigurt.....	50
3.1.17.Vërejtjet, komentet dhe sugjerimet e nxënësve dhe mësimdhënësve.....	53
3.2. Intervista me drejtorët	56
3.2.1. Informimi i nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve me Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar.....	56
3.2.2. Bashkëpunimi me prindër.....	58
3.2.3. Bashkëpunimi me Policinë.....	60
3.2.4. Bashkëpunimi me institucionet tjera.....	61
3.2.5. Bashkëpunimi me OJQ.....	62
3.2.6. Mësimdhënësit në rolin e shërbimit profesional...63	

3.2.7. Trajnimet e mësimdhënësve për menaxhimin e konfliktit dhe trajnime tjera të ngjashme për përballimin e situatave konfliktuoze.....	64
3.2.8. Aktivitetet jashtë kurrikulare, si: ligjërata, debate, aktivitete artistike me temë kundër dhunës.....	64
3.2.9. Kontrollimi i nxënësve për armëmbajtje dhe përdorimit të narkotikëve.....	65
3.2.10. Rastet e dhunës /kërcënimit në shkollë.....	66
3.2.11. Të dhënat për dhunën në shkollë.....	67
3.2.12. Zgjidhja e rasteve në shkollë dhe kërkesa për ndihmë.....	68
3.2.13. Ushtruesit e dhunës dhe viktimat	68
3.2.14. Masat disiplinore për kryesit e dhunës.....	69
3.2.15. Vërejtjet, komentet dhe sugjerimet e drejtorëve	70
3.3. Rezultatet e hulumtimit me zyrtarë policie.....	70
KAPITULLI IV	74
4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	74
4.1. Përfundime	74
4.2. Rekomandime.....	77
Bibliografia.....	80
Shtojca	83

PËRMBLEDHJE

Ky publikim është rezultat i punës hulumtuese të përvojave dhe qëndrimeve të mësimdhënësve, nxënësve, drejtorëve dhe zyrtarëve nga policia e Kosovës, që lidhen me çështjen e sigurisë në shkolla. Shkolla është e obliguar që nxënësve t’u garantojë siguri të plotë dhe ambient të përshtatshëm. Shpesh herë përmbushja e këtij obligimi rrezikohet nga nxënës të tjerë që vijnë shkollën e njëjtë, apo edhe nga nxënës të shkollave tjera, huliganë apo nga persona tjerë të rritur. Për këtë arsye, fokusi i këtij hulumtimi ishte studimi i rreziqeve, ekspozimi i nxënësve ndaj dhunës, praktikat e shkollave si dhe aktivitetet dhe masat që ndërmerren shkollat për parandalimin e dhunës. Qëllimi i hulumtimit është gjetja e përgjigjeve në pyetjet: Cilat janë format e dhunës? Cili është intensiteti i saj? Kush janë ushtruesit e dhunës? Çfarë është bashkëpunimi i shkollës me prindër? Çfarë është bashkëpunimi i shkollës me policinë? Cilat janë masat për ushtruesit e dhunës? Cilat janë aktivitetet për parandalimin e dhunës? Cili është roli i shërbimit profesional?

Në hulumtim është përdorur kombinimi i metodës sasiore dhe metodës cilësore. Mostra e përfshirë në hulumtim përbëhet nga 139 mësimdhënës të shtatë shkollave profesionale dhe të shtatë gjimnazeve nga 14 komuna të shtatë regjioneve të Kosovës, 380 nxënës të këtyre shkollave të klasave të 10 dhe 11, drejtorë dhe zyrtarë nga policia e Kosovës. Instrumentet e përdorura për mbledhjen e të dhënave janë pyetësori për nxënës, pyetësori për mësimdhënës, intervista gjysmë e strukturuar për drejtorë dhe intervista gjysmë e strukturuar për zyrtarë të policisë.

Në fazën e parë janë mbledhur të dhënat përmes hulumtimit kabinetik të cilat janë shqyrtuar, analizuar dhe krahasuar. Në fazën e dytë, janë përgatitur instrumentet e hulumtimit, është bërë pilotimi i tyre dhe pas disa ndryshimeve dhe plotësimeve të vogla, hulumtimi është realizuar në terren me mbledhjen e të dhënave

Të dhënat sasiore janë analizuar me metodën statistikore përmes programit Excel-it dhe janë paraqitur në mënyrë grafike e tabelare. Të dhënat cilësore të mbledhura nga intervistat janë analizuar duke përdorur analizën e interpretimit dhe duke grupuar përgjigjet për çdo pyetje të cilat pastaj janë interpretuar në mënyrë përshkruese.

Edhe pse tendenca e dhunës në shkolla, sipas rezultateve të dala nga hulumtimi është në rënie (mbi gjysma e të anketuarve janë shprehur se në shkollat e tyre vitin e fundit ka më pak dhunë se në vitet paraprake), ende ka raste të shumta të formave të rënda të manifestimit të dhunës, e madje edhe me humbje jetësh të nxënësve siç tregon edhe raporti nga një studim, i realizuar nga policia e Kosovës gjatë prillit, majit dhe qershorit 2015 (Policia e Kosovës, 2015).

Rezultatet e hulumtimi tregojnë se gjendja në shkollat e përfshira në hulumtim nuk është në nivelin e duhur. Rreth 13 % të nxënësve kanë deklaruar se nuk ndjehen të sigurt. Edhe mësimdhënësit e tyre shprehen po thuajse në të njëjtën shkallë. Ngacmimet nga huliganët, sulmet nga qentë endacakë dhe aksidentet nga mjetet e komunikacionit, janë shkaktarët e kësaj pasigurie, kurse vendet më të pasigurta për nxënësit janë hyrjet dhe daljet e shkollës, oborri i shkollës dhe fusha sportive. Edhe

prania e kafeneve në afërsi të shkollës ndikon në sigurinë e nxënësve.

Forma më e theksuar e dhunës është dhuna verbale dhe psikologjike ndaj nxënësve dhe manifestohet me fyerje, tallje dhe përdorim i emrave fyës. Nga të gjithë nxënësit e anketuar, 60.75 %, kanë parë ndonjë nxënës që ka qenë viktimë e dhunës, kërcënimit apo ngacmimit, kurse 16.26 % prej tyre, kanë qenë vetë viktima të dhunës, kërcënimit dhe ngacmimit.

Në shkolla janë të pranishme dukuritë negative si, posedimi i armeve, përdorimi i alkoolit, konsumimi i duhanit si dhe konsumimi i narkotikëve edhe pse në përmasa të ulëta. Edhe mësimdhënësit e kanë pohuar të njëjtën gjë. Prania e armëve të zjarrit është shumë e ulët, kurse atyre të tohta shumë më e madhe. Rreth gjysma e të anketuarve deklarojnë se nxënësit bartin armë të ftohta disa herë gjatë vitit.

Prania e organizatave joqeveritare të jashtme dhe të vendit që merren me trajtimin e dhunës si fenomen, ka mundësuar që përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me to, të organizohen debate, diskutime dhe aktivitete tjera me nxënës, mësimdhënësit e nganjëherë edhe me prindër me temë dhunën dhe parandalimin e saj.

Shërbimi profesional në shkollat në të cilat është realizuar hulumtimi, mungon. Pedagogu dhe psikologu janë të angazhuar në pak shkolla, vetëm në cilësinë e mësimdhënësve të lëndëve përkatëse.

Strategjitë më të përdorura në shkolla për parandalimin e dhunës kanë qenë vendosja e kamerave në hapësirat e shkollës dhe angazhimi i sigurimit. Por jo të gjitha shkollat kanë pasur këtë

mundësi. Shërbimi i sigurimit funksionon vetëm në ato shkolla në të cilat vetë prindërit janë angazhuar për financimin e tij, meqë institucionet nuk sigurojnë buxhet për këtë vend pune.

Prandaj, duke u bazuar në pozitën aktuale në të cilën gjenden, drejtorët dhe mësime të këtyre shkollave kanë theksuar si nevojë të domosdoshme angazhimin e shërbimit profesional, angazhimin e sigurimit dhe instalimin e kamerave të vëzhgimit në hapësirat e shkollës me qëllim parandalimin e dhunës dhe krijimin e një klime të sigurt shkollore.

Fjalë kyçe: Dhuna, siguria, masat, parandalimi, shkolla,.

HYRJE

Dhuna dhe huliganizmi, ngacmimet mes nxënësve, sulmet ndaj mësimdhënësve, përdorimi i armëve dhe dëmet që shkaktohen në mjediset edukativo-arsimore, tashmë janë bërë problem shqetësues në shkollat tona. Këto situata janë brengosëse për nxënësit, prindërit, mësimdhënësit dhe për shoqërinë në tërësi.

Dhuna manifestohet me një llojllojshmëri të gjerë të sjelljeve agresive që ndodhin në mes të nxënësve, prej zgjidhjes së konfliktit nëpërmjet kërcënimit, shtyrjeve e goditjeve me grushte e deri te përdorimi i armëve ndaj njëri tjetrit me ç'rast njëra palë është ushtruesi i dhunës, kurse pala tjetër është viktimë. Kryerësit e këtyre veprave janë kryesisht të rinj. Fakti që ky fenomen është i pranishëm jo vetëm në shkollat e mesme por edhe në shkollat fillore është edhe më shqetësues (Draft-Strategjia për sigurinë në shkolla 2009 – 2011, f. 2). Nuk janë të pakta rastet kur këto sulme dhe përleshje përfundojnë tragjikisht duke marrë jetë nxënësish.

Brengosja për shkak të rritjes së dhunës në jetën e përditshme, sidomos ndërmjet të rinjve, provohet të sqarohet përmes faktorëve të ndryshëm. Ka shumë faktorë të mundshëm të sjelljes agresive dhe dhunës të fëmijëve dhe adoleshentëve të cilët lidhen me individualitetin e tyre, familjen e tyre, ndikimet e shkollës dhe ndikimet tjera shoqërore. Problemet e shumta të fëmijëve dhe të rinjve shpesh janë rezultat i injorimit apo të ndihmës dhe mbrojtjes joadekuate në familje, në shkollë apo mjedis të gjerë (Sokač, 2014 f. 117). Pasiguria dhe dhuna në shkolla është rezultat i ndikimit të faktorëve si:

Faktorët individualë - dija, qëndrimet, mendimet për dhunën, përdorimi i drogës dhe alkoolit, qenia dëshmitar i dhunës apo të

qenurit viktimë e dhunës ndërpersonale, qasja ndaj armëve të zjarrit dhe armëve të tjera;

Faktorët që rrjedhin nga familja - mungesa e dashurisë dhe e mbështetjes prindërore; eksperiencia me dhunën në shtëpi; dënimi fizik dhe keqtrajtimi i fëmijëve; prindërit apo dhe vëllezërit e motrat, të përfshirë në sjellje kriminale;

Faktorët shoqërorë – pabarazia shoqërore-ekonomike, urbanizmi dhe mbipopullimi; zhvillimi i shpejtë ekonomik, shoqëruar me nivel të lartë të papunësisë në mesin e të rinjve; ndikimet e mjeteve të informimit publik; normat shoqërore që përkrahin sjellje të dhunshme; disponueshmëria e armëve; situata e paskonfliktit (MASHT–UNICEF, 2005, f. 2).

Shkolla duhet të ofrojë mjedise të sigurta dhe të shëndetshme që mbështesin mësimin dhe punën për të gjithë. Studimet tregojnë ekzistencën e një lidhje të drejtpërdrejtë mes të arriturave të nxënësve dhe të mjedisit shkollor në të cilin zhvillohet mësimi. Nxënësit janë më të motivuar që të kenë sukses dhe të kuptojnë potencialin e tyre të plotë në institucionet që ofrojnë një klimë pozitive shkollore ku ata ndihen të përfshirë, të mbështetur dhe të sigurt.

KAPITULLI I

1. DHUNA DHE SIGURIA

1.1. Paraqitja e problemit

Dhuna është dukuri e përgjithshme që shtrihet në të gjitha vendet e botës. Shtrirja dhe intensiteti i saj, janë arsye që shumë studiues, institucione, organizata vendore e ndërkombëtare të merren me studimin e këtij problemi dhe prezantimin e të dhënave për praninë dhe llojet e dhunës që ushtrohet mbi nxënës.

Rezultatet e hulumtimeve të ndryshme pedagogjike, sociologjike dhe shëndetësore publike tregojnë se fëmijët dhe të rinjtë të cilët në moshë të re largohen apo e braktisin shkollën, konsumojnë alkool, narkotikë apo duhan, janë të dhunshëm ndaj vetvetes dhe personave tjerë, të prirur për huliganizëm dhe paraqesin popullacionin i cili i ekspozohet rreziqeve të shumta si dhe pasojave për shëndetin e tyre, arritjet e tyre dhe zhvillim të përgjithshëm (Sokač, 2014 f. 117).

Dhuna është një fenomen që mund të paraqitet në shumë forma duke filluar nga akte relativisht të vogla të tilla si sharje ose shtyrje, akte më të rënda të tilla si grushte, shkelma e deri te akte shumë të rënda të tilla si goditje me thikë, gjuajtje me armë dhe vrasje (Johnie J. Allen & Craik. A. Anderson). Përkufizimi më i zakonshëm i dhunës është se ajo është një formë ekstreme e agresionit që si synim kryesor ka shkaktimin e dëmit, lëndimin ose vdekjen (Anderson & Bushman, 2002, f.29).

Në literaturën profesionale dhuna është definuar në shumë mënyra. Sipas Olweus "... një nxënës është abuzuar apo viktimizuar kur ai në mënyrë të përsëritur dhe të përhershme

është ekspozuar ndaj veprimeve negative të një ose më shumë nxënësve" (Olweus, 1998, f. 19). Pra dhuna mund të përkufizohet si një lloj i veçantë i agresionit, në të cilën sjellja ka për qëllim të lëndojë ose të shqetësojë, sjellja ndodh në mënyrë të përsëritur dhe nuk ka baraspeshë të forcës, në mes të një personi më të fuqishëm ose grupi, dhe të një tjetri më pak të fuqishëm.

Organizata Botërore e Shëndetësisë, dhunën e definojnë si përdorim i qëllimshëm i forcës fizike ose i fuqisë, i kërcënimit apo i përdorimit real të saj, kundër vetes, një personi tjetër ose kundër një grupi a komuniteti, pasoja e së cilës çon ose ka mundësi të çojë në plagosje, dëmtim psikologjik, keq -zhvillim, privim ose vdekje. (World Health Organization, 2002, f. 5).

Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, dhunën e definojnë si përdorim i forcës fizike, i shtrëngimit fizik ose psikik, i mjeteve e i metodave të vrazhda ndaj dikujt për ta detyruar të bëjë diçka jashtë vullnetit e dëshirës së tij, për ta nënshtruar e për ta shtypur dikë, për të kufizuar veprimet e dikujt etj. (Fjalori i GjSSH, Rilindja, Prishtinë, 1981, f. 411);

Në teoritë mbi dhunën, sot ekzistojnë mbi dhjetëra klasifikime të dhunës. Sjelljet e dhunshme mund të ndahen në disa lloje, sipas formës së tyre, funksionit dhe sipas asaj se kujt i drejtohet.

Dhuna fizike. Është lloj i dhunës me të cilën mund të lëndohet trupi i personit tjetër me goditje, shkelmim, shtyrje, ngulfatje, rrëmbim dhe shkatërrim të sendeve etj.

Dhuna verbale. Dhuna ku përdoret fjala për lëndimin e ndjenjave të dikujt, si thirrja me emra fyes, kërcënimi, frikësimi, turpërimi, përqeshja për shkak të pamjes apo prejardhjes, është dhunë verbale.

Dhuna sociale. Rastet në të cilat dikush përjashtohet nga shoqëria dhe i shtyn të tjerët për mos shoqërim me personin e caktuar, është dhunë sociale;

Dhuna seksuale. Nënkupton çdo akt seksual, çdo përpjekje për akt seksual, komentet e padëshirueshme seksuale, aktet e trafikimit me qenie njerëzore, ose aktet që drejtohen ndaj seksualitetit të një personi (Protokolli për Pararandalimin dhe Referimin e Dhunës, 2013, f. 5);

Dhuna emocionale/psikologjike. Nënkupton aktet të cilat shkaktojnë ose kanë mundësi të madhe të shkaktojnë dëm në shëndetin ose në zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social të fëmijës;

Dhuna digjitale. Nënkupton çfarëdo forme të dërgimit të mesazheve përmes internetit apo telefonit që ka për qëllim lëndimin, shqetësimin apo çfarëdo lloj tjetër të dëmtimit të fëmijës në formë të videos, tekstit apo fotografive (Protokolli për Pararandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar, Nr. 21/2013).

Dhuna armiqësore dhe instrumentale. Dhuna armiqësore është e motivuar nga dëshira për të lënduar një person dhe është karakterizuar si afektive, sjellje e "nxehtë". Ky lloj i dhunës është i njohur edhe si "e zemëruar", "emocionale", "hakmarrëse". Për shembull, të godasësh dikë që j'u ka bërë të zemëroheni (ndoshta j'u ka fyer), është një shembull i dhunës armiqësore, kurse dhuna instrumentale (e njohur edhe si "me paramendim" dhe dhunë "proaktive"), është e motivuar nga dëshira për të arritur disa qëllime të tjera p.sh., të holla, status social, seks, dhe në mënyrë tipike karakterizohet si sjellje "e ftohtë" që është e qetë dhe e llogaritur. Dëmi i shkaktuar viktimës nga kjo dhunë, është thjesht një mjet për të arritur qëllimin e dëshiruar (Bushman & Anderson, 2001).

Dhuna direkte. Dhuna direkte është ajo kur viktimja është fizikisht i pranishëm, kurse indirekte, kur viktimja mungon fizikisht. Për shembull, ta godasësh dikë në fytyrë do të konsiderohet si dhunë e drejtpërdrejtë fizike, ndërsa angazhimi i një personi për ta goditur personin e njëjtë, është dhunë indirekte fizike, kurse për personin e angazhuar, kjo do të jetë dhunë direkte. Po ashtu të fyesh ndonjë person që ke përball është dhunë verbale direkte, ndërsa në mënyrë anonime t'i drejtohesh përmes e-mail-ve, është dhunë verbale indirekte (DeWall et al., 2012).

Dhuna aktive dhe pasive. Dhuna aktive përfshin angazhimin në sjellje të dëmshme, kurse dhuna pasive përfshin mosveprimin (dështimin) për t'u angazhuar në sjellje të dobishme. Psh. ta shkelmosh apo fyesh ndonjë person, do të konsiderohet dhunë aktive, kurse qëllimisht "të harrosh" për të ftuar dikend në ndonjë gazmend, apo të refuzosh të ndihmohesh dikend që po mbytet, konsiderohen dhunë pasive (Bushman & Huesmann, 2010).

Dhuna e dukshme (e hapur) dhe fshehtë (e mbuluar). Dhuna është një sjellje shumë e dukshme, atëherë kur bëjmë shaka me dikë ose kur e rrahim atë para shokëve të tij. Në të kundërtën, dhuna është e fshehtë kur ajo nuk vërehet drejtpërdrejt si psh. përhapja e thashethemeve në lidhje me njerëzit pas shpinës së tyre (Krähe, 2013).

1.2. Hulumtimet për dhunën dhe sigurinë në shkollë

Studimet për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë janë të shumta. Studimet e para u kryen në fund të viteve të 60-të të shekullit të kaluar në Suedi, dhe ky trend pastaj do të vazhdojë edhe në vendet e tjera skandinave, për shkak se dhuna në shkollë në këto vende ishte bërë problem dominant. Në vitet 80-të, në

Norvegji disa nxënës të një shkolle fillore kishin kryer vetëvrasje për shkak të dhunës së `ushtruar ndaj tyre nga bashkëmoshatarët (M. Mazreku, 2012, - Cituar sipas Sylaj, 2015, f. 3).

Studimet e kësaj natyre në Kosovë janë kryesisht ato të pasluftës shumica prej të cilave janë realizuar nga OJQ të ndryshme. “Për sa i përket studimeve për dhunën ndaj nxënësve kemi hasur disa studime të kryera tek ne, por vetëm një studim lidhur me dhunën ndërmjet nxënësve. Ky studim është bërë nga M. Mazreku i cili ka trajtuar tipologjitë e dhunës ndërmjet nxënësve, shkaqet dhe faktorët e dhunës ndërmjet nxënësve si dhe strategjitë për parandalimin saj” (Mazreku, 2012, - Cituar sipas Sylaj, 2015, f. 3).

Një studim serioz shkencor dhe i plotë, është programi i doktoraturës i kandidatës Mr.sc. Vlora Sylaj *Bashkëpunimi shkollë familje në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë*. Në fokus të këtij studimi është njohja me dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë, intensitetin e saj, pasojat dhe përfshirjen e familjes në shkollë në zgjidhjen e problemeve dhe parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.

Hulumtimet e realizuara deri më tani kryesisht kanë qenë hulumtime të organizatave joqeveritare të vendit apo të jashtme e më pak të institucioneve, në të cilat janë përfshirë numër i vogël shkollash apo komuna ta caktuara pa ndonjë shtrirje më të gjerë regjionale apo në nivel vendi. Hulumtime të këtilla kishin zhvilluar FIQ, KEC, UNICEF, etj.

Forumi i Iniciativës Qytetare (FIQ), Projektin *Siguria në shkolla* (FIQ, USAID, ATRC, 2007) e kishte filluar në vitin 2005, në shkollat e mesme të Gjilanit dhe Ferizajt, e vazhdoi në vitin 2007 në shkollat e mesme të Prishtinës, kurse në vitin 2009 në

komunën e Kaçnikut dhe Hanit të Elezit. Në vitin 2009 FIQ publikoi raportin për sigurinë në shkollat e mesme, duke nënvizuar shkëlqen e rregullave, praninë e armëve të ftohta dhe të zjarrit dhe problemin e dhunës në shkollat e Kosovës.

Qendra për Arsim e Kosovës - KEC, ka zhvilluar disa hulumtime. Me përkrahjen e MASHT-it dhe, UNICEF-it, ka realizuar *hulumtimin Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane/miqësore në shoqëri dhe shkolla* (KEC, UNICEF, 2009), rreth gjendjes së të drejtave të fëmijës dhe gjendjes së sigurisë në shkollat e Kosovës. Në vitin 2011 MASHT-i mbështeti hulumtimin e KEC-it dhe UNICEF-it për botimin e një raporti mbi bazën e projektit *Parandalimi i dhunës në shkolla*.

Instituti Pedagogjik i Kosovës, në vitin 2012 realizoi hulumtimin *Dhuna verbale ndaj nxënësve*, formë e dhunës kjo, e cila nuk ishte hulumtuar më parë në shkollat e Kosovës si një hulumtim i veçant (Potera, 2012).

Në nëntor të vitit 2012, DKA e Prizrenit, ka nënshkruar Memorandumin e mirëkuptimit me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), gjegjësisht Projektin Pulsi Publik për hartimin e Dokumentit të veprimit për siguri në shkollat e Komunës së Prizreni, duke u bazuar në hulumtimin në shkollat e Prizrenit – *Siguria në shkollat e Prizrenit* (USAID, UNDP, 2012). Edhe në komunën e Prishtinës, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), përmes projektit të Pulsit Publik ka realizuar hulumtimin me temën *Siguria në shkollat publike të Komunës së Prishtinës* (USAID, UNDP, 2012) me qëllim të hartimit të Dokumentit të Veprimit për Siguri në shkolla.

1.3. Siguria dhe legjislacioni

Të gjitha, konventat, ligjet, udhëzimet administrative, strategjitë dhe aktet tjera ligjore, ndalojnë çdo lloj dhune ndaj nxënësve. Në shkallë vendi ekzistojnë strategji, dokumente të veprimit për siguri në shkolla, protokole e rregullore të cilat vënë në pah rëndësinë e parandalimit të rreziqeve për zhvillimin e nxënësve, e sidomos parandalimit të dhunës dhe konsumimit të narkotikëve. Me zbatimin e tyre synohet që shkollat të bëhen mjedise të sigurta të nxënies dhe mësimdhënies për nxënësit dhe mësimdhënësit. Duke u nisur nga fakti se dhuna është problem shumë i madh në shkolla, të gjitha këto ligje, rregullore e dokumente tjera, përfshijnë nene dhe pika të veçanta që rregullojnë këtë çështje.

Sipas nenit 4, paragrafi 1 të *Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës*, “Të gjithë personat e punësuar në institucione arsimore, të themeluara sipas këtij ligji, do të ndër marrin të gjithë hapat e arsyeshëm që të sigurojnë se nxënësit dhe punonjësit nuk lëndohen apo u ekspozohen fjalëve dhe veprimeve fyese”, kurse sipas paragrafit 2 të po të njëjtit nen, “Ndalohet ndëshkimi fizik apo çfarëdo forme tjetër e ndëshkimit nënçmues në të gjitha institucionet arsimore dhe aftësuese, qofshin ato publike ose private” (MASHT, 2011, f. 7).

Ligji i Inspeksionit të Arsimit, Nr.2004/37 (MASHT, Nr.2004/37), përcakton të drejtat, detyrat, autorizimet, përgjegjësitë dhe mënyra e punës së Inspeksionit të Arsimit me rastin e kryerjes se veprimeve kundërligjore.

Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës Së Kosovës, Nr. 03/L-068 (MASHT, Nr. 03/L-068), në nenin 5 paragrafi i, parasheh përgatitjen, miratimin dhe implementimin e Rregullores së Punës për shkollat, duke përfshirë Kodin e Mirësjelljes për stafin

menaxherial, mësime dhënësit, personelin tjetër dhe nxënësit, si dhe masat disiplinore.

Udhëzimi administrativ *Ndalimi, ndërprerja dhe inicimi i procedurës disiplinore për personelin edukativo-arsimor* (MASHT, UA, 40/2005), parasheh që inspektori i arsimit, ndalon, ndërpre punën e mësime dhënësit dhe punëtorëve në institucionet edukativo- arsimore, shkencore dhe aftësuese si dhe e fillon procedurën e shqyrtimit të masës disiplinore ndaj tyre, nëse konstaton se: . . . (e) përdor dhunën fizike ndaj fëmijëve, nxënësit, studentëve dhe kolegëve; (ë) përdor dhe shpërndan armë, drogë e gjëra të tjera të ndaluara me ligj; (f) bën ndonjë akt ngacmimi apo dhunimi seksual; (g) nuk i zbaton udhëzimet dhe detyrat nga punëdhënësi dhe mbikëqyrësi arsimor; (gj) merr mito nga fëmijët, nxënësit, studentët dhe prindërit për përmirësim notash, kalim klase, dhënie provimi e të tjera të ngjashme; (h) i obligon fëmijët, nxënësit, studentët që të blejnë mjete, pajisje dhe tekste nga personeli edukativoarsimor për çështje fitimprurëse.

Udhëzimi administrativ, Nr. 06/2014, - Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënësit të shkollave të mesme të larta (MASHT, Nr. 06/2014), përcakton të drejtat, obligimet, veprimet e ndaluara, vijueshmërinë në mësim dhe masat e procedurës disiplinore dhe zbatimin e tyre ndaj nxënësit të cilët i shkelin rregullat e kodit të mirësjelljes (Neni 1). Kodi parasheh veprimet e ndaluara dhe masat disiplinore përkatëse për kryerjen e këtyre veprave.

Strategjia për siguri në shkollë 2009-2011 – Gjatë vitit 2008, MASHT, MPB, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Policia e Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, filluan analizën fillestare të gjendjes për hartimin e Strategjisë për siguri në shkollë me qëllim kryesor parandalimin e sjelljeve asociale dhe

delikvente në institucionet edukatvo-arsimore dhe aftësuese të Republikës së Kosovës. Ishte bërë publike se në prill të vitit 2009, MASHT dhe MPB do të prezantojnë draft-dokumentin “Strategjia për siguri në shkolla 2009-2011 - Shkolla një vend i sigurt”, por strategjia është ende draft-dokument. Ndërkohë që MASHT në vijim do të merret me finalizimin e draftit të Strategjisë për sigurinë në shkolla, të cilën e pati hartuar bashkë MPB, por nuk qe kaluar për aprovim. (Parandalimi i dhunës në shkolla. Përgatiti: Merita Jonuzi, Koordinatorë për të Drejtat e Njeriut/ MASHT).

Aspektet e sigurisë në shkolla adresohen edhe me *Strategjinë nacionale për sigurinë në bashkësi 2011-2016*, prej nga edhe dalin iniciativa dhe projekte të shumta. Ndër to janë edhe iniciativat e komunave për vendosjen e kamerave në shkolla, projekti ndërinstitutional për sigurinë në rrugë, projektet antitrafikim, projektet kundër drogës, parandalimit të dhunës në shkolla etj. (MPB, Strategjia 2011-2016, 2011).

Protokolli për Pararandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar, përcakton detyrimet, qartëson rolet dhe procedurat e institucioneve për parandalimin, identifikimin, mbledhjen e të dhënave, referimin, trajtimin, raportimin e dhunës ndaj fëmijëve në institucionet e arsimit parauniversitar (Neni 1.1 i Protokollit për Pararandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar).

Rregulloret e brendshme të shkollës, ndihmojnë në rritjen e sigurisë së nxënësve brenda mjediseve shkollore. Çdo shkollë harton rregulloren e vet që garanton qëndrim të sigurt në shkollë për nxënësit dhe mbrojtje kundër dhunës.

KAPITULLI II

2. METODOLOGJIA

2.1. Qëllimi dhe objektivat e hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit është identifikimi dhe analiza e gjendjes aktuale të sigurisë në shkolla dhe veprimet që duhet të ndërmerren lidhur me të, nxjerrja e përfundimeve dhe hartimi i rekomandimeve për institucionet vendimmarrëse për parandalimin e dhunës dhe përmirësimin e sigurisë në shkolla.

Objektivat e studimit lidhen me qëllimin që synohet të arrihet me këto objektiva specifike të orientuara në evidentimin e:

- Nivelit të dhunës në shkollë;
- Qëndrimit dhe qasjes së faktorëve relevant ndaj kësaj çështjeje;
- Praktikave të shkollave në parandalimin e dhunës;
- Rekomandimeve konkrete për vendimmarrësit për përmirësimin e sigurisë në shkolla.

2.2. Metodatat

Për të arritur qëllimin dhe objektivat e hulumtimit, janë përdorur metoda sasiore dhe cilësore. Metoda sasiore është përdorur për marrjen e perceptimeve dhe informacioneve nga mësimdhënësit dhe nxënësit për dhunën dhe sigurinë në shkolla më saktësisht, mbi llojet dhe intensitetin e dhunës dhe ngacmimeve, hapësirat dhe kohën kur ushtrohet dhuna, bashkëpunimin me prindërit, komunitetin dhe policinë, masat që ndërmerren ndaj shkaktarëve të dhunës etj.

Të dhënat cilësore për dhunën në shkollë janë marrë nga pyetjet e hapura të pyetësorëve dhe përmes intervistave gjysmë të strukturuar me drejtorë dhe zyrtarë të policisë.

Varësisht nga fazat e zhvillimit të hulumtimit, janë përdorur edhe metodat përkatëse.

Përmes analizës teorike janë konsultuar dhe analizuar punime shkencore dhe profesionale në fushën e sigurisë, me theks të veçantë të sigurisë në shkolla.

Në përputhje me objektivat e hulumtimit, është shfrytëzuar metoda e analizës së dokumentacionit ligjor; janë analizuar ligjet, udhëzimet administrative, strategjitë, vendime të miratuara nga MASHT-i dhe dokumente tjera.

Me metodën krahasuese është bërë krahasimi i rezultateve të fituara nga qasjet sasiore dhe cilësore të hulumtimit, përkatësisht janë krahasuar dallimet në përgjigje të fituara nga nxënësit, mësimdhënësit, drejtuesit e shkollave, zyrtarët dhe ekspertët e arsimit, kurse përmes metodës statistikore janë paraqitur në mënyrë tabelare dhe grafike, rezultatet nga anketimi i zhvilluar me nxënës, mësimdhënë, drejtues të shkollave, zyrtarë dhe ekspertë të arsimit dhe zyrtarë nga policia e Kosovës.

2.3.Instrumentet

Hulumtimi për dhunën dhe sigurinë në shkolla, është realizuar përmes anketimit dhe intervistës.

Anketimi është realizuar përmes pyetësorëve për anketim. Janë hartuar dy lloj pyetësorësh: për mësimdhënë dhe për nxënës. Pyetjet janë të tipit të mbyllur, por ka edhe të tipit të hapur te të dy llojet e pyetësorëve. Shumica e pyetjeve të tipit të mbyllur

kanë vetëm nga një alternativë, kurse të tjerat janë me shumë alternativa. Të dy pyetësorët kanë të dhënat e përgjithshme si mosha, gjinia, kualifikimi, përvoja/klasa etj. dhe pyetjet që lidhen me hulumtimin si perceptimi i dhunës dhe sigurisë, shkaktarët e dhunës, viktimat e dhunës, hapësirat ku ndodh ajo, reagimi ndaj saj, bashkëpunimi me prindër, bashkëpunimi me policinë etj. Disa nga pyetjet e pyetësorëve të mësimdhënësve dhe e pyetësorëve të nxënësve, janë të njëjta me qëllim krahasimi të perceptimeve, qëndrimeve dhe reagimeve të tyre për të njëjtin problem.

Intervistimi është realizuar përmes intervistave gjysmë të strukturuar me drejtorët e shkollave dhe me zyrtarët kompetentë të policisë së Kosovës. Edhe te pyetësi i intervistës ka disa pyetje të njëjta për për të dy kategoritë e të të intervistuarëve.

2.4.Popullata dhe mostra

Popullacioni i hulumtimit përbëhet nga nxënësit, mësimdhënësit, drejtorët e shkollave dhe zyrtarët e policisë së Kosovës.

Nga ky popullacion i gjerë është zgjedhur mostra e hulumtimit nga 9 komuna të Kosovës, më saktësisht 14 shkolla të mesme të larta. Komunat e përzgjedhura për mostër janë: Prishtina, Mitrovica, Gjakova, Theranda, Klina Gjilani, Istogu, Ferizaji dhe Deçani. Nxënësit e përzgjedhur janë nga klasat e 10 dhe të 11 të 7 gjimnazeve dhe 7 shkollave profesionale të zgjedhura në mënyrë rastësore. Mostra e nxënësve të përfshir në hulumtim përbëhet nga 380 nxënës. Nxënësit u takojnë klasave të 10 dhe 11 të 7 shkollave profesionale dhe 7 gjimnazeve.. Në këto shkolla janë intervistuar edhe drejtorët, gjithsej 14, kurse mësimdhënësit kanë plotësuar pyetësorët, gjithsej, 139 mësimdhënës. Përzgjedhja e mësimdhënësve për anketim është bërë në mënyrë

rastësore. Janë anketuar mësimdhënësit që kanë qenë të pranishëm në momentin e vizitës në shkollë. Nga komunat e përmendura më lartë janë përzgjedhur për intervistim edhe zyrtarët nga policia.

2.5.Grumbullimi dhe analiza e të dhënave

Në fazën e parë janë mbledhur të dhënat përmes hulumtimit kabinetik të cilat janë shqyrtuar, analizuar dhe krahasuar. Në fazën e dytë, janë përgatitur instrumentet e hulumtimit, është bërë pilotimi i tyre në një shkollë dhe pas disa ndryshimeve dhe plotësimeve të vogla, hulumtimi është realizuar në terren me mbledhjen e të dhënave përmes pyetësorëve dhe intervistave me mostrën e zgjedhur paraprakisht. Plotësimi i pyetësorëve për nxënës është bërë gjatë një ore mësimore në prani të anketuesit pas sqarimeve të nevojshme për arsyet dhe qëllimin e realizimit të këtij hulumtimi duke iu përkujtuar atyre se pyetësi është anonim dhe shërben vetëm për qëllim studimi. Mësimdhënësit u anketuan në pushim mes orëve ose në pauzën mes dy ndërrimeve. Intervistat e parapara me drejtorët dhe respondentët tjerë u realizuan me diktafon me lejen paraprake të të intervistuarit. Në rastet kur i intervistuari nuk dëshironte të incizohej, intervista shënohej nga intervistuesi.

Të dhënat e hulumtimit janë analizuar përmes metodës statistikore dhe metodës së përmbajtjes. Të dhënat sasiore janë analizuar me metodën statistikore përmes Excel-it dhe janë paraqitur në mënyrë grafike e tabelare. Të dhënat cilësore të mbledhura nga intervistat janë analizuar duke përdorur analizën e interpretimit dhe duke grupuar përgjigjet për çdo pyetje të cilat pastaj janë interpretuar në mënyrë përshkruese.

KAPITULLI III

3. REZULTATET NGA HULUMTIMI

Rezultatet nga pjesëmarrësit e përfshirë në hulumtim, janë paraqitur të sistemuara në pjesë të cilat paraqesin format dhe intensitetin e shfaqjes së dhunës, shkaktarët dhe viktimat e dhunës, hapësirat në të cilat dhuna është më e theksuar, reagimet dhe masat për parandalimin e dhunës, bashkëpunimin më prindër, praninë dhe bashkëpunimin më policinë, si dhe rolin e shërbimit profesional në shkollë.

3.1. Rezultatet e hulumtimit me mësimdhënës dhe nxënës

Rezultatet e hulumtimit me mësimdhënës dhe nxënës kanë dalë nga pyetësorët e hartuar për ta. Pyetësi për mësimdhënës ka gjithsej 26 pyetje (duke përfshirë këtu edhe pyetjet me të dhënat e përgjithshme personale) të cilat trajtojnë informimin e tyre me bazën ligjore, praninë e dhunës në shkollë, format e paraqitjes së dhunës, kush janë ushtruesit e dhunës, masat dhe aktivitetet që ndërmerren për parandalimin e dhunës, bashkëpunimin me prindër si dhe bashkëpunimin me policinë. Pyetjet e parashtruara në këtë pyetësor janë pyetje të tipit të hapur dhe pyetje të tipit të mbyllur. Pyetësi për nxënës ka gjithsej ka 27 pyetje (duke përfshirë këtu edhe pyetjet me të dhënat e përgjithshme personale) të cilat trajtojnë praninë e dhunës në shkollë, format e paraqitjes së dhunës, kush janë ushtruesit e dhunës, kush janë viktimat e dhunës, reagimet e tyre në momentet e manifestimit të dhunës, si dhe pasojat nga dhuna apo reflektimi i dhunës te ta.

Prej gjithsej 139 mësime të ndryshme, 42 % i takojnë gjinisë femërore, kurse 57.35 % gjinisë mashkullore. Nga këta mësime të ndryshme, 26.81 % kanë kryer studimet master, kurse 68.84 % kanë të kryer fakultetin. Vetëm 4.35 % prej tyre janë me ShLP.

Nxënësit e përfshirë në hulumtim janë 203 nga klasa 10 dhe 177 nga klasa 11.


Tabela 1. Struktura e mësime të ndryshme dhe nxënësit

		Nxënësit																
		Klasa 10		Klasa 11				F			M			ShP		Gjimnaz		
Nr.		203		177				219			161			7		7		
%		53.42		46.58				59.35			43.63			50.00		50.00		
Gjithsej		380																
		Mësime të ndryshme																
		Gjinia		Mosha				Kualifikimi			Përvoja							
		F	M	21 - 30	31 - 40	41 - 50	51 - 60	Mbi 60	ShLP	Fakultet	Master	1-5	6-10	11-15	16-20	21-25	26-30	Mbi 30
Nr.		58	78	13	29	29	53	14	6	95	37	14	27	15	17	20	22	21
%		42.65	57.35	9.42	21.01	21.01	38.41	10.14	4.35	68.84	26.81	10.29	19.85	11.03	12.50	14.71	16.18	15.44
PP		3		1				1			3							
Gjithsej		139																

3.1.1. Trajnimet

Për zhvillim profesional është e rëndësishme edhe ndjekja e trajnimeve adekuatë. Nga mësime të ndryshme nuk është kërkuar të evidentojnë të gjitha trajnimet e tyre që kanë vijuar, por vetëm ato që kanë të bëjnë me temën e hulumtimit – dhunën respektivisht sigurinë në shkollë. Prej gjithsej 139 mësime të ndryshme të anketuar, vetëm 37.41 % nga ta, kanë kryer trajnime përkatëse siç janë *Të*

drejtat e fëmijëve 67.31 %, Trajnime psiko sociale 40.38 %, Menaxhimi i konflikteve 15.38 % dhe 11.54 % Të tjera ku përfshihen: Diskriminimi, Barazia gjinore, Trauma, shëndeti, kujdesi për fëmijët, Për trafikimin etj.




Grafiku 1. Trajnimet

3.1.2. Ligjet, Strategjitë, rregulloret

Për t'u respektuar rregulloret e brendshme, ato së pari duhet të njihen dhe kuptohen nga ana e nxënësve, mësimit dhe prindërve, si dhe dënimet për mosrespektimin e rregullave të vendosura. Mësimit për ligjet, strategjitë, udhëzimet administrative dhe rregulloret deklarohen se janë mirë të informuar, më saktësisht, 31.65 %, shumë mirë 43.17 % mirë, kurse 20.14 % janë pak të informuar për legjislativën që rregullon dhe sanksionon dhunën në shkollë. Prej tyre 5.04 % kanë deklaruar se nuk e njohin aspak.

Edhe përgjigjet e nxënësve për informacionin që kanë për ligjet, rregulloret e shkollës dhe kodin e mirësjelljes të cilat rregullojnë dhe sanksionojnë sigurinë dhe dhunën në shkollë, janë përafërsisht të njëjta me ato të mësimit. Për shkollën shumë mirë, janë deklaruar 36.87 %, mirë 43.50 %, kurse pak të

informuar janë rreth 17 %. Vetëm 2.65 % prej tyre shprehen se ligjet dhe rregulloret nuk i njohin aspak.



Grafiku 2. Informacioni për ligjet, rregulloret


Opinionet e mësimdhënësve për bazën ligjore që rregullon sigurinë në shkolla janë të ndryshme. Një përqindje jo e madhe e tyre kanë deklaruar se ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret janë shumë të mira dhe se ato zbatohen plotësisht në shkollat e tyre dhe pikërisht për këtë arsye, shkollat e tyre janë të sigurt. Nga ana tjetër, një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve shprehen se baza ligjore është e mirë por ajo nuk zbatohet me përpikëri sidomos kur nuk merren masa ndëshkuese ndaj shkaktarëve të dhunës dhe kërcënimeve. Edhe rregullat e shkollës janë përpiluar në mënyrë të saktë por zbatimi i tyre nuk është në nivelin e duhur. Ato duhet të vendosen në vende të dukshme ku nxënësit mund të kenë qasje në leximin e tyre dhe jo vetëm kaq por edhe t'u sqarohen atyre nga ana e mësimdhënësve. Disa nga mësimdhënësit mendojnë se ligji duhet të rishikohet. Ai ka nevojë për përmirësim dhe plotësim dhe se ka një vakum ligjor që e rregullon fushën e sigurisë në shkollë e përveç kësaj është shumë i butë sa u përket masave ndëshkuese sepse shkaktarët e dhunës ndëshkohen pak ose aspak dhe kjo i inkurajon ata të sillen

njësoj. Një numër i vogël i mësimitdhënësve janë përgjigjur se nuk kanë njohuri të mjaftueshme se si e rregullon ligji sigurinë në shkollë, si të veprohet me nxënësit të cilët shkelin rregullat dhe sillen dhunshëm në shkollë.

Për sa i përket zbatimit të rregullores së shkollës, 61.59 % prej mësimitdhënësve deklarohen se në shkollat ku ata punojnë, ajo zbatohet plotësisht, kurse 37.68 % prej tyre pjesërisht. Vetëm një mësimitdhënës ka deklaruar se në shkollën e tij, rregullorja e shkollës nuk zbatohet aspak.

3.1.3. Perceptimi i sigurisë në shkollë

Të dhënat nga hulumtimi tregojnë se perceptimet e nxënësve dhe mësimitdhënësve janë përafërsisht të njëjta mes veti. Përqindja më e lartë për të dy kategoritë, rreth 65 % është se nxënësit ndjehen të sigurt në shkollë. Mbi 20 % e mësimitdhënësve mendojnë se nxënësit ndjehen shumë të sigurt, kurse 15.77 % prej tyre shprehen se në shkollë nxënësit janë të pasigurt. Një përqindje shumë e vogël është përcaktuar për opsionin *shumë të pasigurt*.




Grafiku 3. Perceptimi i sigurisë në shkollë

3.1.4. Dhuna dhe kërcënimet/rreziqet për nxënësit gjatë udhëtimit për në shkollë

Rreziqet dhe kërcënimet me të cilat përballen nxënësit gjatë shkuarjes në shkollë dhe kthimit nga shkolla, sipas mësimdhënësve dhe nxënësve të përfshirë në hulumtim, nuk dallojnë shumë mes veti. Rreziku më i madh sipas mësimdhënësve vjen nga mjetet e komunikacionit dhe qentë endacak. Mungesa e ndriçimit në rrugë dhe ngacmimet nga huliganët, paraqesin rrezik për afërsisht të njëjtë për nxënësit.

Edhe perceptimet e nxënësve për kërcënimet dhe rreziqet që i hasin rrugës për në shkollë dhe gjatë kthimit në shtëpi, janë pothuajse të njëjta, me dallime në vlera minimale.



Grafiku 4. Rreziqet/kërcënimet me të cilat ballafaqohen nxënësit

3.1.5. Koha dhe vendi ku nxënësit ndjehen më të pasigurt

Koha më e pasigurt për nxënësit, është koha kur ata shkojnë apo kthehen në shtëpi nga shkolla. Siç shihet nga tabela, kjo pasiguri është më e shprehur sidomos gjatë kthimit në shtëpi. Sipas nxënësve, 13.67 % prej tyre ndjehen çdo herë të pasigurt, 32.17 % shpesh, kurse 27.88 % shprehen se gjatë kthimit nga shkolla ata ndjehen nganjëherë të pasigurt. Edhe koha gjatë pushimeve,

në mes të orëve, orëve të lira apo gjatë aktiviteteve të ndryshme shkollore, nxënësit nuk ndihen shpesh krejt të sigurt.

Tabela 2. Koha dhe vendi ku nxënësit ndjehen më të pasigurt

		Çdo herë		Shpesh		Nganjëherë		Kurrë	
		N*	M**	N	M	N	M	N	M
1	Gjatë shkuarjes në shkollë	6.42	7.87	13.9	30.71	38.24	51.97	41.44	9.45
2	Gjatë orarit të mësimit	1.87	0	4.28	0.83	32.09	13.33	61.76	85.83
3	Gjatë pushimeve (në mes të orëve mësimore)	4.55	0.78	27.01	7.81	38.5	49.81	29.95	42.19
4	Gjatë aktiviteteve shkollore	1.87	0	22.46	1.67	27.54	30	47.86	68.33
5	Gjatë kthimit në shtëpi	13.67	8.8	32.17	28.8	27.88	53.6	26.27	8.8

*) N – nxënës

***) M – mësimdhënës

Të njëjtat perceptime me nxënësit i kanë edhe mësimdhënësit e tyre. Edhe për ta periudha më e pasigurt është ajo e shkuarjes dhe e kthimit nga shkolla. Në pozitën e tretë radhitet koha gjatë pushimit në mes orëve apo orëve të lira. Kohën gjatë orarit të mësimit dhe aktiviteteve shkollore, ata e konsiderojnë shumë të sigurt.

Dhuna ndaj nxënësve shfaqet në ambiente të ndryshme, si në familje, në vendet e argëtimit, në rrugë, në shkollë, në vendet publike, në terrenet sportive. Në hapësirat e shkollës ajo mund të paraqitet ne hyrje të shkollës, në oborr, të fushën e sportit, ne korridor, në klasë e në laborator.

Përgjigjet e nxënësve dhe mësimdhënësve për hapësirat në të cilat nxënësit nuk ndihen të sigurt, nuk janë çdo herë të përafërta. Vendet më të pasigurta sipas nxënësve, janë hyrjet dhe daljet e shkollës. Edhe oborrit e shkollës dhe tualetet po ashtu ata e konsiderojnë si vende të pasigurta. Edhe mësimdhënësit pohojnë se nxënësit më të pasigurt ndihen në hyrje dhe dalje të shkollës, në oborr dhe ne fushën sportive, por dukshëm me përqindje më të

ulët se ajo e nxënësve, kurse laboratorit, shkallët, korridorit dhe tualetet sipas tyre janë hapësira plotësisht të sigurta.

Tabela 3. Hapësirat ku nxënësit ndjehen më të pasigurt

	Nxënësit	Mësimdhënësit
Në hyrje dhe dalje të shkollës	19.12	45.83
Në klasë të zbrazët	5.48	2.08
Në shkallë	5.60	1.04
Në korridor	10.35	4.17
Në laborator	1.83	0.00
Në fushën e sportit	16.69	12.50
Në tualet (WC)	14.01	8.33
Në oborr	24.00	26.04
Në bufe të shkollës	2.92	0.00

3.1.6. Format e dhunës, ngacmimit/kërcënimit

Veprimet që synojnë të dëmtojnë apo denigrojnë ndokënd, manifestohen përmes formave të ndryshme të dhunës. Ajo mund të jetë dhunë fizike, dhunë verbale, dhunë psikologjike, dhunë sociale, abuzim seksual etj. Nxënësit i ekspozohen dhunës fizike të moshatarëve të tyre nga shkolla e tyre apo shkollat tjera apo dhunës së më të rriturve, siç janë goditja me grushte, me shkelma, shtyrje apo goditje me mjete të ndryshme, po ashtu edhe dhunës verbale dhe psikologjike siç janë fyerjet, talljet, etiketimet me emra fyes dhe përhapja e informacioneve personale (foto, mesazhe) përmes telefonit apo internetit. Nxënësit e anketuar deklarojnë se janë penguar ose shtyrë nga të tjerët një apo dy herë gjatë vitit në shkollën prej 27.54 %. Dhunë të njëjtë por në një periudhë më të shkurtë kohore prej një muaji, kanë përjetuar 7.22 % prej tyre kurse 1.07 % i janë ekspozuar për çdo ditë kësaj

forme të dhunës. Sulmet fizike, goditja me shuplakë, grushte ose shkelma, janë të një intensiteti më të ulët; 86.36 % të nxënësve shprehen se ata asnjëherë gjatë vitit nuk kanë përjetuar goditje me shuplakë, grushte apo shkelma. Me nga 0.27 % përfaqësohen ata të cilët kanë pësuar çdo ditë e çdo javë. Edhe kërcënimi për lëndim në rast të mos përmbushjes së kërkesave të caktuara të kërcënuesit, shprehet në shkallë të njëjtë përqindjesh me sulmet fizike. Hulumtimi tregon se dhuna seksuale apo ngacmimimi seksual nuk është i pranishëm ose është pak i pranishëm. Shkalla e ngacmimit seksual është e ulët me një përqindje që nuk është më e lartë se 1.8 % në frekuencën një apo dy herë gjatë vitit kurse për muaj dhe javë është edhe më e ulët. Afër $\frac{3}{4}$ e viktimave të ngacmimeve seksuale, janë të gjinisë femërore.

Detyrimi për të bërë diçka kundër vullnetit të viktimës, është po ashtu një formë e dhunës të cilën e kanë pësuar një apo dy herë gjatë vitit rreth 17 % të nxënësve, kurse një apo dy herë gjatë muajit, afër 5 % prej tyre.

Për dallim nga dhuna fizike, dhuna psikologjike ndaj nxënësve, është më e theksuar dhe manifestohet me fyerje, tallje, përdorim i emrave fyes dhe përhapje thashethemesh e informacionesh personale. Forma dominuese e kësaj dhune është përhapja e thashethemeve. Sipas rezultateve të hulumtimit, 8.31 % e nxënësve janë viktima të përditshme të kësaj dhune, 11.53 % të përjavshme, kurse një apo dy herë në muaj dhe një apo dy herë në vit, viktimizohen rreth 40 % të nxënësve. Edhe talljet, fyerjet dhe drejtimi me emra fyes viktimës, janë shpërndarë me rezultate po thuajse të barabarta sikurse edhe përhapja e thashethemeve.

Shpërndarja për të tjerët e informacioneve apo fotove përmes telefonit apo internetit, që lëndojnë viktimën, është e një shkalle

më të ulët. Një apo dy herë gjatë vitit, viktimizohen diçka më shumë se 20 % e nxënësve, kurse për 3.75 % prej tyre, përhapen informacione një deri dy herë në muaj. Për periudhën ditore apo javore, vlerat janë më të ulëta se 1 %. Thyerja e qëllimshme apo dëmtimi i gjërave të tjetrit, shprehet me 21.45 % për një apo dy herë gjatë vitit. Rezultatet e detajuara nga hulumtimi për format dhe frekuencat e shpërndarjes nga pozita e viktimës, janë paraqitur në tabelën 4.

Tabela 4. Format e dhunës

		kurrë	një apo dy herë gjatë vitit	një apo dy herë gjatë muajit	një apo dy herë gjatë javë	çdo ditë
1	Ju ka shtyrë dhe penguar ndokush	60.70	27.54	7.22	3.48	1.07
2	Ju ka sulmuar fizikisht (godit me shuplakë, grushte ose shkelma)	86.36	13.10	0.00	0.27	0.27
3	Ju ka kërcënuar dikush se do të ju lëndoj në qoftë se ju nuk i jepni atij diçka që është e juaja (p. sh. para, telefon celular, iPod, veshje, etj).	85.03	12.03	1.60	0.80	0.53
4	Ju ka prekur apo ngacmuar seksualisht.	97.06	1.87	0.80	0.00	0.27
5	Ju ka detyruar dikush i që të bëni diçka kundër vullnetit tuaj.	76.41	16.89	4.56	1.61	0.54
6	Bëjnë thash e theme për ju	40.48	18.77	20.91	11.53	8.31
7	Qeshet me ju dhe ju drejtohet me emra fyes	51.88	20.43	17.74	6.18	3.76
8	Dikush ka shpërndarë për të tjerët informacione apo foto që ju lëndojnë ju për mes telefonit apo internetit	73.73	21.18	3.75	0.80	0.54
9	Dikush ka thyer qëllimisht apo dëmtuar diçka që u takon juve	74.80	21.45	1.61	0.27	1.88

Për të njëjtat pyetje nga kjo tabelë, janë përgjigjur nxënësit por tani në rolin e shkaktarit të dhunës, kërcënimit/ ngacmimit. Me ndërrimin e rolit, kanë ndryshuar shumë edhe përgjigjet e dhëna.


Vetëm shtyrja dhe të penguarit e tjetrit ka një përqindje më të lartë (16.58 %) që është ushtruar ndaj viktimës një apo dy herë në vit, kursi sulm fizik, goditje me shuplakë, grushte apo shkelma, kanë kryer 6.95 % prej tyre për të njëjtën periudhë kohore. Mbi 97 % prej të gjithë nxënësve të anketuar, janë shprehur se nuk kanë prekur apo ngacmuar ndokënd seksualisht. Më pak se 2 % prej tyre këtë e kanë bërë një apo dy herë gjatë vitit.

Dhuna verbale dhe psikologjike që ka ushtruar nxënësi ndaj nxënësit tjetër, është më e theksuar. Dallohen tallja me viktimën dhe përdorimi i emrave fyes si dhe shpërndarja e thash e themeve me 15.58 %, përkatësisht 12.60 % me një apo dy herë gjatë vitit. Në periudhën një apo dy herë gjatë muajit, 9.12 % e nxënësve deklarohen se përhapin thashë e theme. Një përqindje pak më e vogël e nxënësve janë shprehur se tallen me ndokënd dhe i drejtohen me emra fyes një apo dy herë gjatë muajit. Shpërndarje të informacioneve personale përmes telefonit apo internetit me qëllim të lëndojnë viktimën, bëjnë 5.09 % të nxënësve një apo dy herë gjatë vitit.

3.1.7. Ushtruesit e dhunës dhe viktimat e dhunës

Dhunën mbi nxënësit mund ta ushtrojnë vetë nxënësit, nxënësit tjerë më të rritur nga e njëjta shkollë, nxënës nga shkolla tjera, huliganë që sillen afër shkollës, mësimdhënësit, prindërit, e persona tjerë të panjohur. Nga të dhënat e hulumtimit rezulton se nxënësit rrezikun më të madh e kanë nga huliganët që sillen në afërsi të shkollës apo gjatë vajtje-ardhjes në shkollë me 81.01 %. Nga nxënësit e shkollave tjera janë të rrezikuar rreth 24 %, kure nga nxënësit më të rritur të shkollës ku ata vijojnë mësimin, mbi 20 %. Një numër më i vogël i tyre ndjehen të rrezikuar nga

moshatarët. Nën kategorinë Tjetër me 1.96 % nxënësit deklarohen se rrezik për ta paraqesin qentë endacakë.



Grafiku 5. Ushtruesit e dhunës dhe ngacmimeve

Gati $\frac{3}{4}$ eshtruesve të dhunës janë djem shumica prej të cilëve në të njëjtën kohë janë edhe viktimat të dhunës. Ata kryesisht shërbehen me dhunën fizike, kurse te vajzat manifestohen format e dhunës verbale, si thashethemet, drejtimi me emra fytes dhe përhapja e informacioneve personale me telefon apo internet. Për djemtë objekt dhune dhe ngacmimi janë djemtë dhe vajzat, kurse vajzat kryesisht si cak të tyre kanë vajzat përmes dhunës verbale. Sipas gjinisë, më shumë se gjysma e nxënësve të gjinisë mashkullore janë viktimat të dhunës dhe kërcënimit.

Tendenca e dhunës në shkollat, sipas rezultateve të dalura nga hulumtimi është në rënie. Mbi gjysma e të anketuarve janë shprehur se në shkollat e tyre vitin e fundit ka më pak dhunë se në vitet paraprake, kurse 26.86 % mendojnë se ajo është njësoj si edhe vitet e më hershme. Për 22 % të nxënësve, dhuna ka pësuar rritje.

3.1.8. Prania e dukurive negative dhe raportimi i tyre nga nxënësit

Nxënësit e anketuar në përgjigjet e tyre kanë deklaruar se në shkollat ku ata vijojejnë mësimin janë të pranishme dukuritë negative si posedimi i armëve, përdorimi i alkoolit, konsumimi i duhanit si dhe konsumimi i substancave narkotike edhe pse në përmasa të ulëta.

Të njëjtin perceptim të gjendjes aktuale në shkolla për prezencën e armëve dhe substancave të ndaluara e shprehin edhe mësimdhënësit madje në vlera shumë të përafërta me ato të nxënësve.

Rreth 97 % të mësimdhënësve pohojnë se në shkollat e tyre, nxënësit nuk bartin kurrë armë zjarri, kurse 2.5 % shprehin se nxënësit e tyre këtë e bëjnë një apo dy herë gjatë vitit. Prania e armëve të ftohta në shkolla është shumë më madhe. Rreth gjysma e të anketuarve deklarojnë se nxënësit bartin armë të ftohta shumë herë gjatë vitit. Për posedimin e drogës dhe substancave tjera narkotike, rreth 99 % të mësimdhënësve shprehin se nxënësit e shkollës së tyre nuk posedojnë substanca të këtuara. Edhe prania dhe konsumimi i alkoolit manifestohet në shifra të ulëta gjë që nuk është njëjtë edhe me konsumimin e duhanit. 37 % nga mësimdhënësit kanë deklaruar se nxënësit konsumojnë duhan çdo ditë. Vetëm 10 % prej tyre pohojnë se konsumimi i duhanit nuk bëhet në shkollën e tyre.

Tabela 5. Bartja dhe posedimi i armëve dhe substancave të ndaluara

		kurrë		një apo dy herë gjatë vitit		një apo dy herë gjatë muajit		një apo dy herë gjatë javës		çdo ditë	
		N	M	N	M	N	M	N	M	N	M
1	Armë të zjarrit	93.89	97.48	3.89	2.52	1.39	0.00	0.56	0.00	0.28	0.00
2	Armë të ftohta	49.58	51.94	25.92	35.66	7.04	10.85	6.48	1.55	10.99	0.00
3	Drogë	90.48	99.17	5.32	0.83	2.52	0.00	0.84	0.00	0.84	0.00
4	Alkool	82.87	86.89	9.55	12.30	2.25	0.00	2.25	0.82	3.09	0.00
5	Duhan	12.67	10.32	5.51	16.67	5.23	15.87	16.25	19.84	60.33	37.30

Gjetja e armëve të zjarrit, armëve të ftohta, drogës dhe alkoolit është e vështirë ose shumë e vështirë sipas mësimdhënësve, kurse ajo e duhanit është e lehtë ose shumë e lehtë në shkallën 55.65 % respektivisht 35.48 %.

Sipas mësimdhënësve numri më i madh i nxënësve nuk raportojnë fare për praninë e armëve të ftohta apo të zjarrit, substancave narkotike, alkoolit dhe duhanit në mesin e nxënësve. Këto përqindje janë shumë të larta dhe sillen prej 81 deri në 93 %. Një përqindje shumë e vogël e mësimdhënësve prej 1 deri në 3 % deklarojnë se shumica e nxënësve lajmërojnë për përdorimin apo posedimin e tyre. Tabela në vazhdim paraqet të dhëna të detajuara për raportimin e nxënësve.

Tabela 6. Raportimi i pranisë së armëve dhe substancave të ndaluara

	Asnjë	Fare pak	Disa	Shumica
Armë zjarri	87.79	7.63	1.53	3.05
Armë të ftohta	65.87	22.22	9.52	2.38
Drogë	93.55	2.42	2.42	1.61
Alkool	81.45	12.10	4.84	1.61
Duhan	34.38	18.75	32.81	14.06

Për dhunën, kërcënimin apo problemet e shkaktuara në shkollë, kodi i mirësjelljes parasheh masa edukativo dosiplotinore. Gati 20 % e nxënësve që janë përfshi në hulumtim kanë deklaruar se shkolla ka thirr prindërit e tyre për problemet që kanë shaktuar në shkollë kurse 4.6 % të nxënësve janë suspenduar nga shkolla.

3.1.9. Reagimet e dëshmitarit (vëzhguesit) ndaj dhunës

Në pyetjen drejtuar nxënësve nëse ata kanë parë ndonjë nxënës që ka qenë viktimë e dhunës, 60.75 % janë përgjigjur pozitivisht. Në pyetjen plotësuese nëse ata që kanë qenë prezent gjatë aktit të dhunës ndaj nxënësit tjetër si kanë reaguuar, kanë dhënë përgjigje të ndryshme. Për opsionin e parë – *nuk kam bërë asgjë*, janë përgjigjur 49.12 %. Për opsionet *i kam treguar mësimdhënësit dhe drejtorit apo zëvendës drejtorit* janë deklaruar 19 % respektivisht 13.27 të nxënësve. Viktimën pas momentit të incidentit e kanë ndihmuar 18%, kurse në momentin e incidentit, 9.29 % prej tyre aq sa edhe kanë thirr policinë.



Grafiku 6. Reagimi vëzhguesit në momentet e dhunës

Nga pyetja vijuese që lidhet me opsionin e parë se nxënësi dëshmitar/vëzhgues nuk ka bërë asgjë, dalin shumë përgjigje. Numri më i madh i të anketuarve, rreth 65 % kanë deklaruar se nuk kanë dashur të futen në telashe. Përgjigje tjetër që ata kanë dhënë me një përqindje prej 35.14 % është *kam pasur frikë*. Për opsionin *kam menduar se po të ndihmoja viktimën, do të përsoja vetë*, janë shprehur gati 1/3 e nxënësve. Dy përgjigje tjera të mundshme, *Kam menduar se edhe po t'i tregoja dikujt, kjo nuk do të ndihmonte asgjë* dhe *Kam menduar se po e keqësoj situatën*, përfaqësohen me nga rreth 20 %.

3.1.10. Reagimet e viktimës

Reagimet e nxënësve që janë viktima të dhunës, kërcënimit apo ngacmimit, janë të ndryshme dhe varen nga nxënësi në nxënës. Ata shpesh përpiqen të fshehin nga të tjerët dhunën e ushtruar ndaj tyre sepse ata mendojnë se do të konsiderohen si frikacakë. Të tjerët nga frika se situata vetëm do të përkeqësohet, e heshtin dhunën dhe pranojnë të vuajnë pasojat e saj. Nga të gjithë nxënësit e anketuar, 16.26 % prej tyre shprehen se kanë qenë viktima të dhunës, kërcënimit dhe ngacmimit.

Çdo e pesta viktimë e dhunës nuk ka bërë asgjë për arsye se ka pasur frikë, nuk ka ditur kujt t'i tregojë dhe çka të bëjë, ka menduar se edhe po t'i tregonte dikujt, kjo nuk do të ndihmonte asgjë, thjesht nuk ka dashur të tregojë, nuk ka dashur të futet në telashe tjera apo është frikësuar se po e keqëson situatën.

Përgjigja më e shpeshtë e viktimave, është se ata u kanë treguar prindërve të vetë rreth 42 %, kujdestarit të klasës 26.67 %, drejtorit apo zëvendës drejtorit 23.33 %. Një e treta e të gjitha viktimave kanë deklaruar se janë mbrojtur, kurse janë hakmarrë

më vonë mbi 20 %. Ndihmë nga të tjerët për ta ndalur dhunën kanë kërkuar 15 %. Nga 8.33 % kanë thirrur policinë, u kanë treguar mësimdhënësve apo i kanë treguar vëllait apo motrës.

Si pasojë e dhunës dhe kërcënimeve, mbi 27 % e viktimave të dhunës dhe kërcënimit, iu është dashur të qëndrojnë në shtëpi dhe të mungojnë nga shkolla.




Grafiku 7. Arsyet e mos reagimit të viktimës

3.1.11. Qendrimet ndaj dhunës

Shkolla, si një vend ku nxënësit në mënyrë të organizuar kalojnë së bashku shumë kohë gjatë ditës, duhet të marrë rolin primar në parandalimin dhe mbrojtjen e nxënësve nga dhuna. Rezultatet më të mira mund të arrihen nëse shkolla nxit një atmosferë respekti, mirëkuptimi dhe tolerance dhe ku problemet dhe mosmarrëveshjet zgjidhen me metoda jo të dhunshme. Shkolla duhet të flas hapur për dhunën, të mos injorojë aktet e dhunës, ta ndalojë atë dhe të dënojë ata që dhunojnë apo kërcënojnë të tjerët. Sipas këtij hulumtimi, rezulton se mbi gjysma e drejtorëve apo zëvendës drejtorëve, njoftojnë për dhunën, kërcënimin dhe ngacmimet çdo herë, 23 25 % njoftojnë shpesh, kurse rreth 17 %,

të drejtorëve, këtë e bëjnë nganjëherë. Mësimdhënësit kanë deklaruar se 7% të drejtorëve nuk informojnë për dhunën dhe kërcënimet.

Dhunën dhe kërcënimet përpiqen ta ndalin çdo herë 66 % e drejtorëve, shpesh mbi 17 %, kurse nganjëherë 11 % e tyre. Aktet e dhunës i injorojnë çdo herë apo shpesh rreth 12 %. Dënimin e ushtruesve të dhunës dhe kërcënimeve e bëjnë çdo herë 59.74 % e drejtorëve, kurse 23 % prej tyre këtë e bëjnë shpesh. Grafiku në vazhdim paraqet në mënyrë më të detajuar qëndrimet e drejtorit, zëvendës drejtorit apo shërbimit profesional të shkollë, për sigurinë.



Grafiku 8. Qendrimet ndaj dhunës

Për dhunën, kërcënimin apo problemet e shkaktuara nga nxënësit në shkollë, kodi i mirësjelljes parasheh masa edukativo disiplinore. 80 % e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim, kanë deklaruar se ushtruesit e dhunës janë suspenduar përkohësisht, kurse 12 % nga ta, janë shprehur se kjo nuk ka ndodh. Nuk janë të informuar nëse nxënësit janë suspenduar apo jo, 7.69 % prej tyre. Mësimdhënësit janë pyetur të deklarohen edhe për llojin e akteve të kryera si goditjet apo fyerjet. Se nxënësi ka ofenduar mësimdhënësin kanë pohuar gati gjysma e

tyre, kurse për 31 %, kjo nuk ka ndodh. 20 % nuk e din nëse dikush nga mësimdhënësit është ofenduar prej nxënësve. Tabela në vazhdim paraqet më detajisht llojet e akteve të ushtruara nga mësimdhënësit dhe nga nxënësit.

Tabela 7. Format e ushtrimit të dhunës

	po	jo	nuk e di
Nxënësi është përjashtuar për kohësisht	80.00	12.31	7.69
Nxënësi ka ofenduar mësimdhënësin	48.84	31.01	20.16
Nxënësi ka goditur mësimdhënësin	7.14	68.25	24.60
Mësimdhënësi ka ofenduar nxënësin	17.97	49.22	32.81
Mësimdhënësi ka rrahur nxënësin	7.09	66.93	25.98

3.1.12. Shërbimi profesional


Pedagogu dhe psikologu janë kompetentë dhe përgjegjës për të kontaktuar, komunikuar e punuar mbi baza të parimeve pedagogjike me atë kategori nxënësish të cilët me sjelljet dhe veprimet e tyre devijante prishin rendin shtëpiak në shkollë. Në pyetjen që ka të bëjë me praninë e një shërbimi të tillë profesional, mësimdhënësit e shkollave të përfshira në hulumtim kanë deklaruar se në shkollat e tyre mungon shërbimi i tillë, por rolin e tij e luan drejtori, Këshilli i shkollë, sigurimi, mësimdhënësit apo ekipi për disiplinë. 53.33 % e mësimdhënësve janë përgjigjur se shërbimi i cili merret me çështjen e sigurisë dhe ruajtjes së rendit në shkollë, është Sigurimi i shkollës, 16.67 % Këshilli i shkollës, 13.33 % pedagogu, kurse 10.00 % policia e Kosovës. 6.67 % e mësimdhënësve shprehen se në shkollat e tyre këtë funksion e kryen Komisioni për disiplinë në shkollë. Lidhur me bashkëpunimin e shkollës me mjekë, psikologë dhe specialistë tjerë për nxënësit që kanë nevojë për mbështetje

shtesë, vetëm 7.25 janë deklaruar se shkolla bashkëpunon çdo herë me ta, 22.46 % nganjëherë, 44.93 %, bashkëpunon sipas nevojë, kurse 24.64 % përgjigjen se nuk kanë bashkëpunuar asnjëherë me pedagogë, psikologë, mjekë e specialistë tjerë. Një mësimpldhënës ka deklaruar se nuk e din nëse shkolla e tij ka bashkëpunuar apo jo.

3.1.13. Bashkëpunimi me prindër

Për të ndihmuar në krijimin e një klimë pozitive dhe të sigurt në shkollë, mësimpldhënësit dhe shkollat duhet në mënyrë aktive të bashkëpunojnë më prindërit dhe t'i përfshinë ata në tërë shumëllojshmërinë e aktiviteteve shkollore duke përfshirë këtu edhe atë të sigurisë. Prania e prindërve në shkollë përmes bashkëpunimit dhe njohja me nevojat dhe problemet e nxënësve, mundëson parandalimin apo të paktën reduktimin e dhunës, krijimin e një klime më të përshtatshme dhe arritjen e rezultateve më të larta për nxënësit. Me qëllim të identifikimit të interesimit për bashkëpunimin me prindërit, mësimpldhënësit janë pyetur se sa ata janë të kënaqur me këtë bashkëpunim, sa informohen prindërit e nxënësve për përjetimin e dhunës dhe ngacmimeve në shkollë dhe sa ata informojnë mësimpldhënësin për gjendjen dhe sjelljet e fëmijëve të tyre. Në përgjithësi mësimpldhënësit nuk janë të kënaqur me bashkëpunimin me prindër duke theksuar se mungon sidomos bashkëpunimi me prindërit e nxënësve që janë më të pasjellshëm. Pjesa më e madhe e tyre, apo 74.82 % kanë deklaruar se janë pak të kënaqur, 6.47 % nuk janë fare të kënaqur, kurse vetëm 18.71 % shprehen shumë të kënaqur me këtë bashkëpunim.

Informimi i prindërve dhe informimi nga prindërit, qëndrojnë në raport disproporcional. Sipas mësimdhënësve 43.88 % prej tyre gjithmonë informojnë prindërit për përjetimin e dhunës dhe ngacmimeve në shkollë, 18.71 % shpesh, 20.14 % nganjëherë, kurse 13.67 % kanë deklaruar se ata rrallë informojnë prindërit. Vetëm 3.60 % prej tyre nuk e kanë bërë këtë asnjëherë. Sipas mësimdhënësve kështu nuk veprojnë prindërit në raport me ta. Informimi nga ana e prindërve është i ulët. Sipas tyre, vetëm 12.23 % e prindërve informojnë mësimdhënësin për fëmijët e tyre gjithmonë, 10.70 % shpesh, 38.85 % nganjëherë, kurse 26.62% e mësimdhënësve janë përgjigjur se prindërit informojnë mësimdhënësin rrallë.



Grafiku 9. Bashkëpunimi me prindër

3.1.14. Bashkëpunimi me policinë dhe prania e saj në shkollë

Të gjithë të punësuarit në shkollë janë të detyruar të parandalojnë dhunën që ndodh dhe të reagojnë në rast dyshimi se ajo po ndodh në shkollë. Për zgjidhjen e këtij problemi, shkolla duhet të


bashkëpunojë me policinë, qendrat sociale, institucionet shëndetësore, etj.

Policia e Kosovës është përgjegjëse për të mbrojtur jetën dhe pronën e qytetarëve të Kosovës duke përfshirë këtu edhe sigurimin e një ambienti të përshtatshëm shkollor ku nuk do të ketë dhunë dhe sjellje asociale. Edhe shkollat në aktivitetet e tyre parashohin format e bashkëpunimit me policinë. Gati gjysma e mësimitdhënësve të përfshirë në hulumtim, mendojnë se ky bashkëpunim me policinë bëhet sipas nevojë, me kërkesë të vetë shkollës, kurse për 31.39 % të tyre, ekziston një bashkëpunim i rregullt me policinë. Sipas një numri më të vogël të mësimitdhënësve, bashkëpunimi është i herë pas hershëm.

Qëndrimet e mësimitdhënësve për praninë e policisë sillen prej kërkesës që policia duhet të jetë patjetër e pranishme në shkolla e deri te qëndrimet kategorike se ajo kurrsesi nuk duhet të jetë në shkollë. Nga gjithsej 139 mësimitdhënës të anketuar, 61.31 % prej tyre deklarohen për praninë saj, kurse 39.42 % janë kundër. Kjo prani organizohet me vendosjen e policisë së përhershme, përmes vizitave apo patrullimeve, përmes ligjëratave edukative, përmes policëve civilë apo vetëm kur ndodhin incidentet. Nga rezultatet e hulumtimit del se gjysma e të anketuarve parapëlqejnë praninë e policëve civilë dhe organizimin e ligjëratave edukative në shkollë, rreth 36 % prej tyre shprehen për vizitat e patrullave policore, kurse 11.90 % janë për vendosjen e policisë së përhershme në shkolla. Vetëm 4.76 % dëshirojnë praninë e policisë vetëm kur ndodhin incidentet.

Edhe qëndrimet e nxënësve për praninë dhe formën e pranisë së policisë, në shkolla janë përafërsisht të njëjta me ato të mësimitdhënësve. Prej tyre 26 % shprehen se policia është rregullisht në shkolla, kurse për 30 %, ajo është e pranishme herë pas herë. 8 % të nxënësve kanë deklaruar se policia nuk ka qenë

në shkolla asnjëherë. Pyetjes së parashtruar nëse policia duhet të jetë e pranishme apo jo, pozitivisht i janë përgjigjur 91.18 % prej tyre, kurse 8.82 % mendojnë se policia nuk e ka vendin në shkolla. Format e pranisë së policisë sipas nxënësve, janë ato për të cilat janë deklaruar edhe mësimitdhënësit por me vlera pak më të ulëta. Vetëm për vendosjen e policisë së përhershme, dallimi është i më i theksuar mes mësimitdhënësve dhe nxënësve. Për këtë formë janë deklaruar 40.11% të mësimitdhënësve, kurse te nxënësit kjo përqindje është vetëm 11.9 %.



Grafiku 10. Bashkëpunimi dhe prania e policisë në shkollë

3.1.15. Çka mundë të bëjnë mësimitdhënësit për një shkollë më të sigurt

Rezultatet e dala nga hulumtimi dëshmojnë edhe një herë për rolin e pazvëndësueshëm të mësimitdhënësit në edukimin dhe parandalimin e dhunës në shkolla. “Bashkëpunimi i ndërsjellë ndihmon shumë. Preventiva është shumë e nevojshme. Biseda me nxënësit dhe prindërit e tyre rreth sigurisë është më se e duhur. Le të mos lejojmë që të bëhet vonë”, thotë një mësimitdhënës.

Mësimdhënësit në pyetjen se *çka mundë të bëjnë ata vetë për një shkollë më të sigurt?* në ngritjen e sigurisë në shkollë, theksojnë angazhimin maksimal në punën e tyre të përditshme dhe bashkëbisedim me nxënësit në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve. Këto biseda janë grupe por edhe individuale varësisht nga natyra çështjeve që janë objekt diskutimi. Mungesa e orës së kujdestarisë nuk na e mundëson shumë këtë bashkëbisedim. Problemet e nxënësve duhet t'i diskutojmë edhe ne mësimdhënësit mes veti – pohojnë ata.

Ne duhet të jemi të hapur me ta, më tolerant dhe t'i kuptojmë shqetësimet dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen. Problemet e tyre t'i zgjidhim në bashkëpunim me ta e madje edhe me prindërit e tyre. Duhet po ashtu të jemi më vigjilentë dhe të kujdesshëm në parandalimin e incidenteve duke punuar më shumë në aspektin edukativ rreth sigurisë në shkollë përmes aktiviteteve të ndryshme dhe trajnimeve e seminareve nga mësimdhënësit të shkollës apo edhe ekspertë të fushave të ndryshme, mjekë, psikologë, sociologë, prindër etj. Këto trajnime dhe ligjerata edukative mund të realizohen edhe nga organizata joqeveritare. Do të ishte mirë që të përgatiten programe të përshtatshme trajnimi nga MASHT-i dhe institucione tjera për ngritjen e vetëdijes për pasojat e dhunës për nxënës dhe prindër. Përveq debateve e ligjëratave, si formë e aktiviteteve që ndikojnë në parandalimin e dhunës dhe rritjes së sigurisë, janë përgatitja e fletushkave që tregojnë shembuj të mirë të mirësjelljes, posterëve, ekspozita të punimeve të nxënësve apo shfaqje të ndryshme.

Gati të gjithë mësimdhënësit e anketuar kanë deklaruar se respektimi i rregullave të shkollës dhe funksionalizimi i masave që kanë aprovuar DKA-të dhe MASHT-i, ndikojnë në parandalimin e dhunës dhe krijimin e një ambienti më të sigurt.

Një numër i konsiderueshëm i tyre theksojnë mbajtjen e kujdestarisë me përgjegjësi duke e shtuar edhe numrin e mësimdhënësve kujdestarë në të gjitha katet dhe anekset e shkollave. Edhe diçka që duhet të bëjmë, por që nuk do të dëshironim ta bëjmë, është t'i kontrollojmë se mos po bartin me vete gjëra të ndaluara dhe të kemi kujdes sidomos te nxënësit të cilët cilësohen më problematikë në mënyrë që të punojmë shumë më tepër me ta.

Bashkëpunimin më prindër, mësimdhënësit po ashtu e konsiderojnë si faktorë shumë të rëndësishëm edhe pse siq thonë ata ky bashkëpunim nuk është në nivelin e duhur nga ana e prindërve si dhe raportimi i rasteve të kujdestari i klasës, mësimdhënësit tjerë apo të drejtori që shërben si masë parandaluese.

Kërkesat e nxënësve nga mësimdhënësit e tyre kanë qenë më këmbëngulëse sidomos sa u përket masave që duhet ndërmarrë ndaj ushtruesve të dhunës. Mësimdhënësit duhet të ndërmarrin masa për largimin e nxënësve për të cilët ata mendojnë se janë të rrezikshëm. Ndaj tyre duhet zbatuar dënime më të rrepta, sepse kjo është e vetmja mënyrë e efikase për parandalimin e dhunës. Kontrollimi në hyrje të shkollës për armë dhe mjete tjera të rrezikshme, ndalimi për hyrjen e nxënësve të shkollave tjera në oborrin e shkollës, angazhimi i shërbimit të sigurimit dhe vendosja e kamerave për vëzhgim, po ashtu ndikojnë në krijimin e një mjedisi të sigurt për të gjithë. Kujdestaria e ditës po ashtu duhet të jetë në nivel. Mësimdhënësit duhet të jenë më shumë në korridore dhe në hapësira tjera të shkollës gjatë pushimit mes orëve. Ata duhet të kenë kujdes që nxënësit mos t'i largojnë nga orët e mësimi.

Edhe për nxënësit, bashkëpunimi i mësimitdhënësve me kujdestarin e klasës, kujdestarin e ditës, sekretarin, drejtorin, policinë e Kosovës dhe me prindërit, është i domosdoshëm. Nxënësit duhet të informohen për çdo herë për incidentet që ndodhin. Prindërit duhet informuar përmes e-mailit ose sms.

Aktivitetet për vetëdijesim duhet të organizohen përmes debateve, publikimit të broshurave dhe ekspozitave.

3.1.16. Çka mundë të bëjnë nxënësit për një shkollë më të sigurt

Shkolla është e të gjithëve, e nxënësve, e mësimitdhënësve, e prindërve si dhe e komunitetit e të gjithë këta së bashku kanë përgjegjësi në krijimin e një klime pozitive dhe të sigurt në shkollë. Që një shkollë të jetë e tillë, të gjithë mësimitdhënësit e përfshirë në hulumtim, theksojnë respektimin e kodit të mirësjelljes dhe rregulloreve të shkollës të cilat përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve në shkollë. Ata duhet të jenë të sjellshëm, të respektojnë njëri tjetrin dhe rregulloren e shkollës, të jenë të rregullt në vijimin e mësimit, t'i përmbahen orarit mësimor më përpikëri si dhe të bartin uniformën për t'u dalluar nga rrugaçët dhe personat e jashtëm. Që shkolla të jetë e sigurt, sipas mësimitdhënësve, nxënësit duhet që të raportojnë te mësimitdhënësi, te kujdestari i klasës, te mësimitdhënësit tjerë apo te organet e shkollës për çfarë do lëvizje që vërejnë e që prish rendin dhe sigurinë në shkollë pa marrë parasysht a është fjala për shokët dhe shoqet e klasës, nxënës të klasave tjera apo të afërm. Ata po ashtu duhet të përcjellin debatet dhe ligjëratat që herë pas herë organizohen në shkollë nga mësimitdhënësi apo edhe OJQ të

ndryshme, të mësojnë për të drejtat e fëmijëve, të drejtat e njeriut, të vetëdijesohen për respektin dhe tolerancën, dhe të kuptojnë se dhuna sjell vetëm pasoja negative. Një element tjetër që e bën shkollën edhe më të sigurt sipas mësimdhënësve që nxënësit duhet ta kenë parasysh, është bashkëpunimi. Nxënësit duhet të bashkëpunojnë mes veti, me kujdestarin e klasës, me mësimdhënësit tjerë, me drejtorin si dhe me prindërit dhe t'i paraqesin rastet të cilat rrezikojnë sigurinë në shkollë. Edhe organizimi i debateve për luftimin e dhunës dhe dukurive tjera negative dhe aktiviteteve vetëdijesuese nga vetë nxënësit, ndikon që shkolla të bëhet një ambient edhe më i sigurt shprehën mësimdhënësit. Dhe krejt në fund por jo edhe për nga rëndësia, nxënësit duhet të vijnë në shkollë rregullisht dhe nuk duhet të bartin kurrë me vete armë zjarri, armë të ftohta, drogë, alkool etj. sepse këto janë tepër të rrezikshme për sigurinë e tyre dhe të tjerëve - është mesazhi i të gjithë mësimdhënësve drejtuar nxënësve.

Nxënësit kanë nevojë që tu ipet mundësia të kontribuojnë në mirëqenien dhe zhvillimin e shkollës së tyre përmes aktiviteteve të veçanta si brenda klasës ashtu edhe jashtë klasës. Ata mund të ndikojnë në ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljet e shokëve të tyre që shkaktojnë dhe nxisin dhunë, kërcënime e ngacmime. Të gjithë së bashku mund të ndihmojnë në krijimin e një ambienti shkollor ku nuk ka dhunë dhe të gjithë nxënësve u garantohet siguria. Edhe qëndrimet e nxënësve për rolin e tyre në krijimin e një ambienti pa dhunë, të dala nga ky hulumtim, janë në frymën e këtij synimi. Pjesa më e madhe të anketuarve theksojnë respektimin e rregullores së shkollës dhe kodin e mirësjelljes. Sipas tyre, nxënësit duhet të jenë të sjellshëm, të dëgjojnë

këshillat e drejtorit dhe mësime të shkollës dhe të lajmërojnë çdo parregullësi. Një faktor tjetër i rëndësishëm të cilin e kanë theksuar nxënësit që ndikon në krijimin e një shkolle edhe më të sigurt, është informimi dhe denoncimi i sjelljeve të papranueshme. *Ne mund të ndalojmë konfliktet me njëri tjetrin dhe të mos mbajmë gjëra të rrezikshme, duke raportuar çdo rast dhune apo ngacmimi në mënyrë që të merren masa ndaj atyre personave që i shkaktojnë këto* – shprehet një nxënës. Bashkëpunimi mes nxënësve, bashkëpunimi me drejtorin, mësime të prindërit dhe me policinë është po ashtu shumë i rëndësishëm. Shumë nxënës kanë deklaruar se vendosja e posterëve në mure, mbajtja e mbledhjeve të kryesive të klasave dhe rinisë shkollore, organizimi i aktiviteteve të ndryshme dhe debateve vetëdijesuese ku shqyrtohen tema lidhur me rreziqet nga posedimi i mjeteve të ndaluara dhe konsumimi i substancave të rrezikshme, ndikojnë në parandalimin e dhunës dhe bëjnë që shkolla të jetë më e sigurt për ta. Duhet të bisedohet më shumë me nxënësit të cilët mund të jenë kryes të këtyre veprimeve si pasojë e konflikteve të mëhershme me nxënësit tjerë. *Edhe drejtori, kujdestari i klasës dhe mësime të tjerë duhet të punojnë edhe më shumë dhe t'i këshillojnë nxënësit e këtillë* – thotë një nxënës. Një numër i konsiderueshëm i nxënësve mendojnë se nxënësit e pasjellshëm duhet të dënohen në mënyrë të rreptë. *Masat që po ndërmerret drejtori me suspendim për disa ditë nuk po kanë efekt sepse pas disa ditësh, nxënësi përsëri po kthehet në shkollë dhe po vazhdon me të vjetrën. Unë mendoj se vetë ne nxënësit duhet të inicojmë përjashtimin e këtyre nxënësve* – deklaroi një nxënës. Veprimet e dhunshme në shkollë ndodhin edhe për arsye se mungojnë kamerat me të cilat nxënësit do të mund të vëzhgoheshin dhe kjo me siguri do të ulte shkallën e

sjelljeve të këtilla të papranueshme. Edhe mungesa e sigurimit reflektohet në mugesën e sigurisë në shkolla dhe pikërisht për këtë nxënësit e shumë shkollave ku mungon ky shërbim kanë kërkuar angazhimin e tij. Një numër i konsiderueshëm i nxënësve kanë kërkuar kontrollimin e shpeshtë të nxënësve për bartjen dhe posedimin e armëve, mjeteve të ndryshme të forta dhe substancave narkotike si dhe vendosjen e policisë së përhershme në shkollë. Kërkesa për bartjen e uniformave apo identifikimi i nxënësve përmes ID-ve, është kërkesë e një numri të vogël të tyre.

3.1.17. Vërejtjet, komentet dhe sugjerimet e nxënësve dhe mësimitdhënësve

Nxënësit

- Të vendosen kamerat e sigurisë si dhe angazhohet në shkollë punëtori i sigurimit;
- Të mos lejohen nxënësit e shkollës të dalin shumë herë në korridor;
- Profesorët të marrin masa kundër nxënësve të pasjellshëm sepse vërejtjet nuk po mjaftojnë;
- Të flasin për edukatën, dhunën dhe parandalimin e drogave;
- Të kontrollohen banjot dhe pjesa e pasme e shkollës me qëllim pengimin e problemeve dhe ndërprerjen e pirjes së duhanit;

- Mendoj se duhet të këtë më shumë policë civilë afër marketeve dhe kafiteriva pranë shkollës me qëllim evitimin e incidenteve;
- Çdo klasë të këtë ekipin e vetë që kryen aktivitete të ndryshme në luftimin e akteve të dhunshme dhe të takohen më shpesh;
- Nxënësit të kenë uniforma në mënyrë që të dallohen që janë nxënës të kësaj shkollë, policia të jetë më e pranishme në shkollë;
- Psikologu, mjeku dhe policia duhet të jenë të pranishëm në shkollë;

Mësimdhënësit

- Prindërit duhet të jenë më shumë prezent në shkollë të fëmijët e tyre;
- T'u mundësohet shkollave që të kenë psikolog, në mënyrë që të zvogëlohen problemet me nxënësit që kanë nevojë të këshillohen nga ana profesionale e psikologut;
- Do të ishte mirë që përgatiten programe të përshtatshme trajnimi nga MASHT-i dhe institucione tjera për ngritjen e vetëdijes për pasojat e dhunës për nxënës dhe prindër;
- Ende duhet të punohet nga të gjitha institucionet kompetente brenda dhe jashtë shkolle;
- Të angazhohen mediat më tepër në aktivitetet që organizon shkolla për çështjet e sigurisë dhe dhunës;

- Nxënësit të pajisen me uniforma;dhe të kontrollohen në hyrje të oborrit të shkollës;
- Shkollat të jenë bazë e inspektimit permanent nga organet kompetente të të gjitha fushave e sidomos pushteti lokal mos ta shoh shkollën vetëm si vendpunësim;
- Të merren masa më të rrepta ndaj nxënësve që nuk u përmbahen rregulloreve të shkollës ndaj;
- Të vendosen kamerat e sigurisë në korridore dhe tualete;
- Të rritet bashkepunimi në mes mësimeve dhe prindërve;
- Të punohet në ngritjen e vetëdijes së nxënësve për vendin dhe rolin e tyre në zhvillimin e shoqërisë dhe shkolla të shndërrohet në një institucion të fuqishëm arsimor;
- Një angazhim më i madh i DKA-së;
- Në mënyre institucionale të mirrehi shumë më tepër me problematikat e arsimit dhe edukimin e rinisë;
- Të punohet më shumë në parandalimin dhe zhdukjen e dhunës në mesin e nxënësve me ushtruesit e dhunës dhe viktimat;
- Së paku 2 herë ekspertë të sigurisë të mbajnë ligjëratat për sigurinë në shkolla dhe jashtë shkollës;
- Mbyllja e kafeneve në afërsi të shkollave.

3.2. Intervista me drejtorët

Për plotësimin e informacioneve mbi gjendjen aktuale të sigurisë dhe ushtrimin e dhunës në shkolla, janë realizuar intervista me drejtorët e 14 shkollave nga shtatë regjionet e Kosovës. Mostrën e drejtorëve e përbëjnë drejtorët e shtatë gjimnazeve dhe shtatë shkollave profesionale në të cilat është realizuar edhe anketimi i nxënësve dhe mësimitdhënësve përmes pyetësorëve.

3.2.1. Informimi i nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve me Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar

Nga intervistat me drejtorët e shkollave të përfshira në hulumtim rezulton se një pjesë e e madhe e mësimitdhënësve dhe nxënësve janë të njoftuar me *Protokollin (rregullore – qrk nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar)*. Paralelisht me këtë protokol, drejtorët u referohen në përgjithësi edhe dokumenteve, strategjive, ligjeve, udhëzimeve administrative, rregulloreve dhe kodit të mirësjelljes që merren me rregullimin e sigurisë dhe sanksionimin e dhunës që ushtrohet në shkolla qoftë mes nxënësve brenda shkollës apo edhe me nxënës dhe persona tjerë që në një mënyrë janë në kontakt me nxënësit e shkollave.

Në fillim të vitit mbajmë mbledhje ku mësimitdhënësit njoftohen për te gjitha udhëzimet administrative, rregulloret, kodin e mirësjelljes, masat disiplinore që shqiptohen nëse shkelin rregullat e shkollës – thonë drejtorët në intervistat e tyre.

Disa prej drejtorëve kanë informuar mësimdhënësit e tyre duke u dhënë adresën e web faqes nga ku e kanë shkarkuar këtë Protokol, kurse disa të tjerë e kanë shtypur atë dhe e kanë shpërndarë të mësimdhënësit në formë të shtypur. Një numër më i vogël i drejtorëve kanë pohuar se nuk janë të informuar për këtë Protokol/rregullore, por njohin ligjin për arsim parauniversitar, ligjin e komunave, udhëzimet administrative, rregulloret dhe kodin e mirësjellje që rregullojnë këtë qështje.

Prindërit informohen përmes kujdestarëve të klasëve. Kujdestarët më detalisht i njoftojnë prindërit për rregullat me të cilat garantohet siguria në shkolla, si dhe për masat që ndërmerren nga kujdestari, drejtori apo edhe Drejtoria e Arsimit e Komunes në rast se shkeljet e këtyre rregullave janë të një natyre shumë të rëndë.

Informimi i prindërve për këto ligje, rregullore e udhëzime administrative është më i ulët. Kjo është për arye se së pari edhe niveli i arsimimit të tyre është pak më i ulët dhe arsye tjetër është se jo çdo herë dhe të gjithë prindërit janë të rregullt në mbledhjet e prindërve që janë të parapara apo në takime individuale me kujdestarët e klasave, kanë deklaruar disa drejtorë.

Mendoj se janë të informuar – thot një drejtor. Nxënësit dhe mësimdhënësit e di se janë mirë të informuar sepse vetë jam angazhuar që në takime me ta, të cilat i organizojmë herë pas herë, i kam njoftuar dhe kemi diskutuar bashkë për rregulloret dhe zbatimin e tyre nga të gjithë ne, kurse prindërit ndoshta në një masë më të vogël.

Nxënësit dhe mësimdhënësit janë mirë të informuar, sepse rregulloren ua lexojnë nxënësve kujdestarët e klasave e po ashtu ajo ekspozohet edhe në mur, kurse prindërit janë në informim e sipër shprehet një drejtor. Një tjetër drejtor përgjigjet se nuk ka njohuri se sa janë të informua.

3.2.2. Bashkëpunimi me prindër

Për krijimin e një klimë pozitive dhe të sigurt në shkollë, është i domosdoshëm bashkëpunimi me prindërit dhe përfshirja e tyre në shumë aktivitete shkollore duke përfshirë këtu edhe sigurinë. Komunikimi i hapur dhe perspektiva e marrë nga shtëpia dhe nga shkolla ndihmon në krijimin e kësaj klime dhe inkurajon një qasje të përqendruar në zgjidhjen e problemeve dhe reduktimin e dhunës në shkolla.

Bashkëpunimi është i kënaqshëm. Ka bashkëpunim të mirë. Prindërit vijnë në mbledhje të prindërve. Takohen me kujdestarët por edhe me mua për problemet dhe preokupimet e nxënësve. Disa prindër interesohen jo vetëm për suksesin dhe sjelljet e fëmijëve të tyre por edhe për nevojat dhe problemet e shkollës në përgjithësi. Këtu ndikon edhe kultura familjare që është në nivel, sepse vërtetë prindërit e nxënësve të shkollës sonë na kanë ndihmuar shumë edhe në aspektin e sigurisë deklaroi drejtori i një shkolle.

Bashkëpunimi më prindër nuk është në nivelin e duhur. Ata nuk bashkëpunojnë aq sa do të duhej me ne. Kryesisht ata nxënës prindërit e të cilëve nuk bashkëpunojnë me ne, na sjellin më shumë probleme. Ne ju kemi bërë thirrje edhe përmes kujdestarëve gjatë mbledhjeve me prindër që ata të jenë faktorë i

rëndësishëm në shumë procese që zhvillohen në shkollë. Këtë e kemi bërë edhe përmes Këshillit të prindërve në mënyrë që edhe ata të ndikojnë në ngritjen e vetëdijes për rolin e rëndësishëm që ka pjesëmarrja dhe përkrahja e tyre në aktivitete të ndryshme shkollore, pohan një drejtor.

Deri diku. Ne po mundohemi. Duhet të thirren disa herë prindërit, sepse siç e dini nxënësit e shkollave profesionale kanë edhe punë praktike dhe komunikimi dhe bashkëpunimi është shumë i rëndësishëm për ne si shkollë, për nxënësit dhe sigurisht edhe për prindërit e tyre të cilët dëshirojnë të jenë të informuar për çdo gjë e sidomos për mbajtjen e punës praktike, meqë ajo mbahet nëpër firma, kompani, organizata të ndryshme jashtë shkolle apo nëpër lokale hotelerie. Kështu që duhet të jemi jashtëzakonisht të kujdesshëm në këtë aspekt – përgjigjet një tjetër.

Në përgjithësi shumica e të intervistuarëve, deklarojnë për një bashkëpunim relativisht të mirë, por që megjithatë ka vend për ngritjen e tij në një shkallë më të lartë.

Bashkëpunimin më prindër drejtorët e realizojë kryesisht në mbledhjet që janë të parapara, nga dy mbledhje për gjysëm vjetor përmes kujdestarëve të klasave, por edhe në takime tjera të rastit si dhe takime individuale. Për organizimin e ndonjë takimi apo debati për shqyrtimin e problemit të dhunës dhe sigurisë në shkollë, ku do të përfshiheshin së bashku mësimmësuesit, nxënësit dhe prindërit, nuk është deklaruar ndonjë drejtor.

Prindërit problemet dhe kërkesat e veta i diskutojnë me kujdestarët e klasave në mbledhjet e rregullta. Shpesh edhe unë marrë pjesë në këto mbledhje. Ka raste kur prindërit drejtohen personalisht te unë – janë shprehur disa drejtorë.

Disa drejtorë tjerë shprehin paknaqësi në komunikimin dhe bashkëpunimin e disa prindërve të cilët edhe pas thirrjeve të shumta me telefon, e-mail, me ftesa apo mesazhe, ngurrojnë të vijnë në shkollë. Kemi numrat e tyre të telefonit dhe kontaktojmë në rast nevojë. Por megjithatë brenda vitit e gjejmë formën komunikimit dhe bashkëpunimit.

3.2.3. Bashkëpunimi me Policinë

Në intervistat e këtij hulumtimi të realizuara me drejtorët e shkollave, theksohet se policia e Kosovës është përfshirë këtu për sigurimin e një ambienti të përshtatshëm shkollor ku nuk do të ketë dhunë dhe sjellje asociale. Shkollat në aktivitetet e tyre parashohin format e bashkëpunimit me policinë.

Ne kemi bashkëpunim shumë të mirë me policinë. Ata janë policë civilë. MASHT dhe Ministria e Punëve të Brendshme kanë bashkëpunim për siguri në shkolla. Stacioni më e afërt policor kujdeset për shkollën tonë, e po ashtu për këtë shkollën tjetër e cila gjindet këtu afër shkollës sonë sepse janë më së afërmi me këtë stacionin policor që e përmenda. Ata janë shumë të rregullt. Vazhdimisht janë këtu për rreth shkollës në vëzhgim. Ata vin këtu për t'i larguar ata që pengojnë mësimin, por nuk ka pasur shumë raste të tilla – shprehet drejtori i një shkolle.

Policia vëzhgon edhe shkollat tjera këtu në afërsi të shkollës sonë, por më së shumti rrinë në shkollën tonë. Ata janë civilë. Pa uniformë. Sillen kendej pari vazhdimisht. Por pas dite atyre u përfundon orari në ora tre, e ata nuk janë më këtu. Pasi ne punojmë në dy ndërrime është dashur që ata të jenë prezentë edhe në ndërrimin e pas ditës sepse mendoj se ka nevojë. Kam bërë kërkesë disa herë por si duket ajo është ende në shqyrtim –

ankohet një drejtor për mungesën e policisë në shkollën e tij në ndërrimin e dytë.

Të gjitha shkollat kanë pohuar se bashkëpunimi me policinë është shumë i mirë, shkollat janë nën vëzhgim të vazhdueshëm prej tyre, i përgjigjen menjëherë thirrjes së shkollës e cila posedon numrin kontaktues me ta për intervenim të shpejt në rast nevojë.

3.2.4. Bashkëpunimi me institucionet tjera

Mësimdhënësit, nxënësit, prindërit dhe drejtori i shkollës, nuk janë të vetmit faktorë të cilët rrisin cilësinë, garantojnë sigurinë dhe parandalojnë dhunën. Pa një bashkëpunim të qendrueshëm me institucione tjera jo vetëm arsimore, nuk do të përmbushej misioni për shkolla cilësore dhe të sigurta.

Shumica e drejtorëve të shkollave janë shprehur se bashkëpunimi me institucionet tjera është në nivelin e kënaqshëm. Së pari bashkëpunojmë me MASHT-in. Ju e dini se ligjet, rregulloret, udhëzimet, strategjitë dhe politikat arsimore zhvillohen në MASHT. Ne jemi implementuesit e gjithë asaj që planifikohet dhe hartohet atje. Kështu që pa një bashkëpunim të mirëfillt nuk mund të jemi të suksesshëm. Me Inspektoratin po ashtu kemi bashkëpunim të mirë, sepse ai na ndihmon shumë në zgjedhjen e problemeve që dalin si rezultat i ushtrimit të dhunës apo shkeljeve të rregullores së shkollës. Edhe me DKA –në kemi bashkëpunim të mirë thonë drejtorët.

Bashkëpunimin me policinë po ashtu e kanë theksuar të gjithë drejtorët e intervistuar. Disa nga ta kanë përmendur edhe bashkëpunimin me shkolla tjera si dhe me qendrën sociale për arsye se në disa raste ka qenë e nevojshme angazhimi i punëtorit

social lidhur me nxënësit prindërit e të cilëve kanë pasur probleme familjare brenda familjes.

3.2.5. Bashkëpunimi me OJQ

Prania e organizatave joqeveritare të jashtme dhe të vendit që veprojnë në Kosovë, dhe shumë prej të cilave merren me trajtimin e dhunës si fenomen i shpesht jo vetëm këtu por edhe në vendet tjera, ka nxitë nevojën e një bashkëpunimi të vazhdueshëm me to. Format më të shpeshta të këtij bashkëpunimi kanë qenë organizimi i debateve, diskutimeve dhe aktiviteteve tjera me nxënës, mësimdhënës e nganjëherë edhe me prindër me temë dhunën dhe parandalimin e saj.

Gati të gjitha shkollat janë deklaruar së kanë pasur madje nga disa aktivitete ne formë ligjëratash e debatesh me OJQ të ndryshme me tema Kundër dhunës, *Luftimi i narkomanisë, për një shkollë më të sigurt etj.*

Ashtu siq keni ardhë ju sot, shkolla jonë vërshohet nga këto iniciativa. Shkolla jonë është shkollë e madhe dhe vërtetë kemi realizuar shumë takime me OJQ të ndryshme. Siguria është brengë për të gjithë. Do të duhej që siguria të ishte në shkallen më të lartë të mundshme sepse kurr nuk është mjaftë, pavarësisht që janë bërë përpjekje – thotë drejtori i një shkolle.

Edhe në shkollën tonë kemi ngritur debate rreth temave për të drejtat e gruas dhe të drejtat e gruas dhe fëmijëve. Kanë marrë pjesë edhe nga MASHT-i. Në këtë projekt ishin të përfhira tri shkolla.

Për nxënësit e klasave të 10 në një shkollë është realizuar një ligjëratë kundër dhunës, me miratimin e DKA-së, kurse në një

shkollë tjetër, është mbajtur një ligjëratë nga disa psikologë dhe është debatuar për luftimin e narkomanisë.

3.2.6. Mësimdhënësit në rolin e shërbimit profesional

Personat më kompetentë për të kontaktuar, komunikuar e punuar mbi baza të parimeve pedagogjike me nxënësit të cilët me sjelljet dhe veprimet e tyre devijante prishin rendin shtëpiak në shkollë, janë pedagogu dhe psikologu.

Shërbimi profesional në shkollat në të cilat është realizuar hulumtimi, mungun. Pedagogu dhe psikologu janë të angazhuar në disa shkolla, por në cilësinë e mësimdhënësve të lëndëve përkatëse. Drejtorët e këtyre shkollave kanë autorizuar këta mësimdhënës vullnetarisht me disa detyra dhe përgjegjësi që lidhen me sigurinë në shkolla dhe parandalimin e dhunës, si psh. Formimi i ekipit apo ndonjë komisioni të sigurisë në shkolla, organizim ligjëratash e debatesh rreth kësaj teme, këshilla dhe udhëzime për nxënësit problematikë, mbajtjen e evidencës së rateve të dhunës dhe sjelljeve asociale etj.

Po e kemi një komision për çështje të dhunës, brenda këshillit të prindërve i cili merret me dhunën dhe parandalimin e saj - shprehet drejtori i një shkolle.

Me mbi 1800 nxënës sipas rregullores, shkollës sonë i takon shërbimi pedagogjik, por në mungesë të buxhetit, komuna nuk është në gjendje të sigurojë të ardhura për ta dhe puna mbetet kështu si është – deklaroi drejtori i një shkolle. Në të njëjtën mënyrë përgjigjen edhe drejtorët e shkollave tjera. Kanë pedagogë dhe psikologë në shkollat e tyre, por vetëm si mësimdhënës lënde e jo si shërbim profesional. Arsyeja e

mosfunktionalizimit të këtij ëshërbimi, është mungesa e sigurimit të buxhetit nga komuna.

3.2.7. Trajnimet e mësimdhënësve për menaxhimin e konfliktit dhe trajnime tjera të ngjashme për përballimin e situatave konfliktuozë

Meqë objekt studimi është siguria në shkolla, dhuna dhe parandalimi i saj, nga drejtorët nuk është kërkuar të deklarohen për të gjitha llojet e trajnimeve që kanë vijuar mësimdhënësit e shkollës së tij, por vetëm për ato trajnime të cilat lidhen me objektin e studimit, pra dhunën dhe parandalimin e saj.

Trajnimet të cilat i numërojnë drejtorët janë po ato të cilat i kanë shënuar edhe mësimdhënësit në pyetësorin e tyre. Janë këto *Trajnime për menaxhimin e konfliktit, Trajnime për të drejtat e fëmijëve, Trajnime psiko-sociale, Trafikimi etj.*

Disa drejtorë vetëm kanë deklaruar se mësimdhënësit kanë vijuar disa trajnime pa specifikuar se cilat janë ato. Disa të tjerë, nuk e dinë sepse tani vonë janë bërë drejtorë. Ka edhe prej atyre që përgjigjen se në shkollën e tij mësimdhënësit nuk kanë vijuar trajnime të tilla.

3.2.8. Aktivitetet jashtë kurrikulare, si: ligjërata, debate, aktivitete artistike me temë kundër dhunës

Sipas drejtorëve, aktivitetet jashtëshkollore, janë të pranishme në shumicën e shkollave. Kryesisht ato janë ligjërata e debate, aktivitete të ndryshme senzibilisuese me fletëpalosje, postera dhe

ekspozita piktore që lidhen me temën e studimit. Këto ligjërata mbahen nga OJQ të vendit apo të jashtme.

Një OJQ që merret me menaxhimin e konfliktit ka mbajtur një trajnimin për nxënësit dhe mësimsdhënësit e shkollës sonë, kurse një tjetër OJQ një trajnim për ndërmjetësimin. Edhe policia ka mbajtur ligjërata herë pas here. Tema e ligjërimit ka qenë lufta kundër përdorimit të drogave Mendoj se për tema të ngjashme, duhet të debatohet edhe më shpesh - ishte përgjigja e një drejtori.

Nga shkolla jonë në një trajnim lidhur me të drejtat e fëmijëve që është mbajtur nga një shoqatë, ka shkuar një mësimsdhënës me disa nxënës, sekretarja e shkollës dhe unë – ka deklaruar një tjetër drejtor.

Disa nga drejtorët e përfshirë në hulumtim kanë pohuar se debate e ligjërata për nxënësit e tyre organizojnë vetë mësimsdhënësit, kryesisht ata të Edukatës Qytetare, pedagogu apo psikologu i shkollës.

3.2.9. Kontrollimi i nxënësve për armëmbajtje dhe përdorimit të narkotikëve

Të gjithë drejtorët shkollave në të cilat është realizuar hulumtimi kanë deklaruar se bëhen kontrollime të herë pas hershme apo të shpeshta të nxënësve për mbajtje të armëve të zjarrit, të ftohta, mjeteve tjera të forta apo substancave narkotike. Këto kontrollime i bëjnë kujdestarët e ditës, kujdestarët e klasave apo edhe punëtorët e shërbimit të sigurimit në rastet kur dyshohet për posedim të gjërave të palejueshme ose ekziston informacioni për këtë.

U kam tërhequr vërejtjen kujdestarëve të klasave që të jenë të kujdesshëm dhe kontrollojnë nxënësit kur dyshohet në ta ose ekziston rreziku i bartjes së tyre nga nxënësit të cilët kanë qenë ushtrues të dhunës apo edhe viktima të dhunës sepse ekziston rreziku i përshkallëzimit të situatës në shenjë hakmarrjeje nga ana e viktimës shprehet drejtori i një shkolle.

Një numër i vogël i drejtorëve kanë pohuar se në shkollat e tyre janë gjetur armë të ftohta.

3.2.10. Rastet e dhunës /kërcënimit në shkollë

Në shumicën e shkollave, nuk ka përdorim të theksuar të dhunës, por kryesisht raste ngacmimi dhe forma tjera të dhunës.

Në shkollën tonë në gjysëmvetorin e parë ka pasë rrahje në mes nxënësve për shkak të vajzave. Situata ka filluar të acarohet por për fat isha afër dhe ndërhyra në momentin e duhur. Në bisedë me nxënësit e përfshirë, kujdestarin e klasës dhe prindërit e tyre, arritëm të zgjidhim konfliktin, t'i pajtojmë ata dhe gjithçka përfundoi mirë.

Dy nga drejtorët e intervistuar kanë pohuar se ka pasur therrje të cilat për fat nuk kanë përfunduar tragjikisht. Rasti ka ndodh jashtë shkolle në mes të një nxënësi të shkollës sonë dhe një nxënësi të shkollës tjetër. Ky ka qenë rasti më i rëndë i cili na ka prekë më së shumti dhe na ka lënë pa frymë. Ata kishin qenë në konflikt edhe më heret. Diçka që mendoj se nuk është në rregull, janë masat që ndërmerren ndaj ushtruesve të dhunës e sidomos kur është fjala për raste të rënda siç është rast i nxënësit të shkollës son por edhe të disa shkollave tjera. Masat e shqiptuara

ndaj tyre nuk janë efektive. Pas suspendimit, nxënësi përsëri po kthehet në shkollë dhe po vazhdon me të vjetrën shprehet drejtori.

3.2.11. Të dhënat për dhunën në shkollë

Drejtori i institucionit të arsimit para-universitar sipas rregullores për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, është i obliguar të sigurojë, ruajë dhe të analizojë të dhënat mbi dhunën e paraqitur në institucionin që ai/ajo drejton, në mënyrën më të mirë të mundshme. *Regjistri i rasteve në institucionet e arsimit para-universitar* nënkupton bazën e të dhënave në të cilën regjistrohen rastet e raportuara të dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar (neni 1. Paragrafi 17 i Protokollit për Pararandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar Nr. 21/2013, f. 5).

Drejtorët e shkollave kanë deklaruar se mbajnë shënime mbi llojin e dhunës së ushtruar, statusin e ushtruesit të dhunës, statusin e viktimës, statusin e rastit dhe pasojat e kësaj dhune. Kemi fletore të posaçme me shënime për rastet e dhunës në shkollë ku shënohet të gjitha të dhënat e nevojshme, shënimet e përgjithshme për kryesin e veprës, viktimën, numrin e bisedave, këshillimeve dhe masat e shqiptuara për rastin konkret – përgjigjën shumica e drejtorëve.

Nuk jam shumë i informuar për këtë, por e kam angazhuar pedagogun dhe ai mban këto të dhëna. – thotë drejtori i një shkolle.

Numri i rasteve të dhunës dhe shqyrtimi i tyre dallon nga shkolla në shkollë. Ky numër sillet prej dy deri në pesë raste.

3.2.12. Zgjidhja e rasteve në shkollë dhe kërkesa për ndihmë

Sipas rregullores për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, të gjitha rastet e dhunës të paraqitura në shkollë duhet të shqyrtohen menjëherë nga drejtori i shkollës.

Sipas përgjigjeve të drejtorëve, shqyrtimi i rasteve të dhunës është bërë në shkollë. Së pari kemi bërë përpjekje që vetë t'i zgjidhim konfliktet e nxënësve këtu në shkollë me mësimdhënësit dhe nxënësit. Në rastet kur nuk kemi pasur sukses, kemi kërkuar ndihmën e prindërve. Disa i kemi dorëzuar në polici.

Nuk ka pasur nevojë të ndërhyhet nga jashtë sepse rastet nuk kanë qenë të rënda – shprehet një drejtor.

3.2.13. Ushtruesit e dhunës dhe viktimat

Sipas shumicës së drejtorëve djemtë janë edhe ushtrues të dhunës edhe viktima të dhunës. Kryesisht është dhunë fizike. Një numër më i vogël prej tyre shprehen se edhe vajzat nganjëherë mund të ushtrojnë dhunë kryesisht ndaj vajzave.

Viktima të dhunës janë si djemtë po ashtu edhe vajzat. Nuk mund të them vetëm djemt apo vajzat. Më tepër është problemi i moshës. Janë në moshën kur nuk mund t'i zgjedhin lehtë problemet qofshin edhe ato krejt banale si *pse më shikon ashtu?*, *çafre po sheh këtu* e të ngjashme apo dhe thjesht dëshirojnë të imponohen para vajzave.

Nuk ka pasur ndonjë nxënës që ka qenë viktimë e dhunës, disa herë, por ka pasur nxënës që kanë ushtuar dhunë më tepër se njëherë ndaj të tjerëve, janë përgjegjur drejtorët në pyetjen nëse viktima ka pësuar disa herë apo kryesi ka ushtruar dhunë disa herë.

3.2.14. Masat disiplinore për kryesit e dhunës

Masat disiplinore që ndërmarrin drejtorët e shkollave ndaj kryesve të dhunës shqiptohen sipas rregullores së shkollës.

Masat që ne ndërmarrim varen nga shkalla e shkeljes së rregullave shkollore. Masat i aplikojmë në bazë të rregullores. Së pari i bëjmë vërejtje me gojë, pastaj me shkrim, pezullimi prej tri ditësh. Pastaj drejtori mund ta suspendojë edhe për një priudhë ma të gjatë. Nëse vepra është e rëndë ose nxënësi bënë më shumë se 32 mungesa ta pa arsyeshme, ai propozon DKA-së që ajo të marrë vendim për nxënësin konkret.

Masa parandaluese për kryerësin e mundshëm që ndërmarrin drejtori, mësimdhënësit apo kujdestari i klasës, janë bisedat, këshillimet, fushata e aktivitete të ndryshme për vetëdijesimin e nxënësve me pasojat e dhunës. Duhet kushtuar vëmendje më tepër nxënësve që janë të prirur të shkaktojnë konflikte. Si masë parandaluese që ndërmerr shkolla, është komunikim dhe bashkëpunimi me prindërit.

3.2.15. Vërejtjet, komentet dhe sugjerimet e drejtorëve

- Shkolla të sigurojë angazhimin e rojeve (shërbimit të sigurimit) të hyrja e shkollës në oborr si dhe të sigurojë vendosjen e kamerave brenda shkollës dhe vëzhgimin e ambientit të jashtëm;
- Prania e lokaleve në afërsi të shkollës reflektohet edhe në sigurinë në shkollë;
- Të gjithë mekanizmat të punojmë së bashku që të jemi të suksesshëm;
- Udhëzimet administrative duhet të përpunohen dhe tu përshtaten proceseve dhe mjedisit shoqëror në bazë të nivelit të vetëdijes së përgjithshme;
- Konsideroj se çdo shkollë duhet të ketë pedagogun dhe psikologun për kujdesin ndaj nxënësve problematikë.

3.3. Rezultatet e hulumtimit me zyrtarë policie

Protokolli për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar, përcakton qartë detyrimet e policisë së Kosovës në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të të gjithë personave. Neni 13, paragrafi 1 alineja 4, parasheh bashkëpunimin e policisë me institucionet qendrore, lokale dhe komunitetne me qëllim të parandalimit dhe luftimit të

krimin për shtimin e sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar. I njëjti nen në paragrafet në vazhdim thekson kontributin në rritjen e vetëdijes rreth natyrës së krimit, dukurive negative dhe sjelljet e dhunshme në institucionet e arsimit parauniversitar. Neni 14 parasheh krijimin e partneritetit bahkëpunues me institucionet e arsimit para-universitar duke iniciuar aktivitete përkatëse për të ngritur vetëdijen tek nxënësit rreth natyrës së krimit, dukurive negative dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, realizimin e patrullimeve të rregullta afër shkollave, në veçanti në ato shkolla ku vërehet shtimi i dukurive negative si dhe caktimi i përfaqësuesit të saj kontaktues me shkollat.

Një zyrtarë i policisë për bashkëpunim me shkollat pohon se në krahasim me periudhën e kaluar, bashkëpunimi është zbehur shumë edhe pse prezenca jonë është çdo herë aty sa herë që e do nevoja.

Me strategjinë e punës që titullohet Policimi në komunitet, janë policët e sektorëve ata që janë të obliguar të bashkëpunojnë me drejtorë të shkollave ose edhe me personelin tjetër të shkollave, varësisht se për cilën shkollë është fjala e cila i takon një sektori të caktuar meqë secili stacion policor është i ndarë në sektore. Polici që punon në atë sektor ka për obligim të vizitojë bizneset, institucionet, shkollat e atij sektori, të krijojë raporte me qytetarët e edhe me shkollat po ashtu patjetër.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me prindër mungon. Meqë nxënësit janë të moshës jo madhore, prindërit na drejtohen pasi të ndodhë rasti. Ata janë të mitur dhe patjetër që duhet të jetë i pranishëm edhe prindi gjatë zhvillimit të procedurave. Për këtë

janë ngritë edhe qendrat për punë sociale. Mirëpo në aspektin preventiv nuk janë shumë aktiv.

Për mbajtjen e ligjëratave dhe trajnimeve rreth sigurisë në shkolla, këta zyrtar deklarohen se çdo herë në fillim të vitit shkollor me ciklin e ulët mbajnë ligjërata lidhur me sigurinë në trafik, kurse me të rriturit kryesisht për drogë, për rolin e policimit në komunitet, dhe kryesisht tema rreth sigurisë sepse çdo polic sipas plan programit gjatë shkollimit e kryen kursin bazik ku përfshihen këto, e më vonë me rastin e avancimit kryen edhe kurse dhe trajnime për komunitete.

Sipas statistikave që ne kemi, nuk ka raste të rënda nëpër shkolla. Është një rënie e dukshme e dhunës. Mendoj se instalimi i kamerave ka ndikuar shumë në zvogëlimin e rasteve të dhunës, kurse pranë shkollës, gjatë shkuarjes në shkollë apo gjatë kthimit nga shkolla, raste ka por ato nuk trajtohen si raste nga shkolla. Këto raste janë zakonisht rrahje në mes të rinjsh të cilët kanë qenë në konflikt edhe më parë ose edhe për arsye të ndryshme të pa rëndësishme si *të kam thënë..., më ke thënë..., unë jam më i fort...,* pastaj nga konfliktet nga Face book ose edhe për vajza. Në konfliktet për rreth shkollës ndikojnë edhe lokalet që gjinden në afërsi të tyre, sepse aty frekuentojnë me të madhe edhe nxënësit e sidomos kur në afërsi gjenden dy apo më shumë shkolla.

Tabela 8. Incidentet në shkolla dhe në afërsi të tyre gjatë vitit 2014*

RASTET E PARAQITURA NË SHKOLLA DHE NË AFËRSI TË TYRE GJATË VITIT 2014														
	Rastet e Paraqitura	Mujet												Gjithsej
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
1	Vrasje	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
2	Lëndim i lehtë trupor	14	14	11	8	6	4	0	0	15	12	14	9	107
3	Lëndimi i rëndë trupor	1	1	0	2	0	0	0	0	1	4	1	0	10
4	Prishje e rendit dhe qetësisë publike	5	6	9	7	4	1	0	1	5	4	6	6	54
5	Vjedhje	8	8	8	7	6	8	2	2	6	9	8	2	74
6	Vjedhje e rëndë	6	6	3	1	4	1	1	0	3	5	5	5	40
7	Posedim i substancave narkotike	1	1	3	2	2	2	0	0	0	2	1	1	15
8	Dëmtim prone	2	7	6	3	9	9	5	7	4	3	6	4	65
9	Posedim i armës së zjarrit	0	1	0	0	1	0	0	0	0	2	3	0	7
10	Posedimi i armës së ftohtë	25	2	3	4	3	0	0	2	0	1	6	0	46
11	Posedim i sendeve të rrezikshme (tjera)	8	2	2	0	1	0	0	0	0	2	2	1	18
12	Zjarrëvënje	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1	0	2
13	Tentim Vetëvrasje	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
14	Grabitje	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0	2
15	Kanosje	2	4	3	1	3	2	0	1	1	4	6	2	29
16	Pengim i personit zyrtar	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	2
17	Ngacim seksual	1	0	0	1	1	0	0	0	0	1	1	0	5
18	Tjera	4	5	3	4	4	1	0	1	2	4	3	1	32
	Gjithësej	79	57	52	41	46	29	8	14	38	53	63	31	511

*) Burimi: Policia e Kosovës, Rexha K. S. & Cakolli M., (2015, f. 4).
Parandalimi i dhunës në shkolla dhe deluquencës së të miturve

Ushtruesit e dhunës janë meshkujt, por ka tendencë që kjo dukuri të paraqitet edhe te femrat. Nga raportet e deritashme shihet se viktimat në të shumtën e rasteve janë meshkuj, kurse një numër shumë i vogël janë femra.

Sa i përket kontrollimit ne nuk e bëjmë atë nëpër shkolla. Vetëm kur kemi informata të sigurta se nxënësit bartin diçka me vete, atëherë po, – deklaron një zyrtar policie.

KAPITULLI IV

4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

4.1. Përfundime

Të dhënat nga hulumtimi tregojnë se perceptimet e nxënësve dhe mësimeve janë përafërsisht të njëjta mes veti. Përqindja më e lartë për të dy kategoritë, rreth 67% është se nxënësit ndjehen të sigurt në shkollë. Mbi 20% e mësimeve mendojnë se nxënësit ndjehen shumë të sigurt, kurse 15.77% prej tyre shprehin se në shkollë nxënësit janë të pasigurt.

Rreziqet dhe kërcënimet më të mëdha me të cilat përballen nxënësit gjatë shkollës në shkollë janë mjetet e komunikacionit, qentë endacak dhe ngacmimet nga huliganët.

Vendet më të pasigurta sipas nxënësve, janë hyrjet dhe daljet e shkollës, oborri i shkollës dhe tualetet. Edhe mësimeve konsiderojnë se nxënësit më të pasigurt ndihen në hyrje dhe dalje të shkollës, në oborr dhe në fushën sportive, me përqindje më të ulët se ajo e nxënësve.

Dhuna verbale dhe psikologjike ndaj nxënësve, është më e theksuar se sa dhuna fizike dhe karakterizohet me fyerje, tallje, përdorim i emrave fyes, si dhe përhapje thashethemesh dhe informacionesh personale.

Nxënësit rrezikun më të madh e kanë nga huliganët që sillen në afërsi të shkollës apo gjatë vajtje-ardhjes në shkollë me 81.01%. Nga nxënësit e shkollave tjera janë të rrezikuar rreth 24 %, kure nga nxënësit më të rritur të shkollës ku ata vijojnë mësimin, mbi 20%.

Rreth 97% të mësimdhënësve pohojnë se në shkollat e tyre, nxënësit nuk bartin kurrë armë zjarri, kurse 2.5% shprehen se nxënësit e tyre këtë e bëjnë një apo dy herë gjatë vitit. Prania e armëve të ftohta në shkolla është shumë më madhe. Rreth gjysma e të anketuarve deklarojnë se nxënësit bartin armë të ftohta shumë herë gjatë vitit, kurse konsumimi i duhanit për një numër të madhë nxënësish është i përditshëm.

Gjysma e nxënësve të anketuar nuk kanë reaguar fare në situatat e dhunës ndaj nxënësit tjetër, duke mos dashur të futen në telashe, kurse rreth ¼ kanë kërkuar ndihmë në raste të këtilla.

Nga të gjithë nxënësit e anketuar, 16.26% prej tyre shprehen se kanë qenë viktimat të dhunës, kërcënimit dhe ngacmimit. Ata shpesh përpiqen të fshehin nga të tjerët dhunën e ushtruar ndaj tyre sepse ata mendojnë se do të konsiderohen si frikacakë. Të tjerët nga frika se situata vetëm do të përkeqësohet, e heshtin dhunën dhe pranojnë të vuajnë pasojat e saj.

Mësimdhënësit nuk janë të kënaqur me bashkëpunimin me prindër duke theksuar se mungon sidomos bashkëpunimi me prindërit e nxënësve që janë më të problematikë. Pjesa më e madhe e tyre, apo 74.82% kanë deklaruar se janë pak të kënaqur, 6.47 % nuk janë fare të kënaqur, kurse vetëm 18.71% shprehen shumë të kënaqur me këtë bashkëpunim.

Nga intervistat me drejtorët e shkollave të përfshira në hulumtim rezulton se një pjesë e e madhe e mësimdhënësve dhe nxënësve janë të njoftuar me *Protokollin (rregullore – qrk nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar)*.

Prania e organizatave joqeveritare të jashtme dhe të vendit që merren me trajtimin e dhunës si fenomen i theksuar, ka nxitë nevojën e një bashkëpunimi të vazhdueshëm me to në formën e organizimit të debateve, diskutimeve dhe aktiviteteve tjera me nxënës, mësime të mësuara dhe nganjëherë edhe me prindër me temë dhunën dhe parandalimin e saj

Shërbimi profesional në shkollat në të cilat është realizuar hulumtimi, mungon. Pedagogu dhe psikologu si përfaqësues të këtij shërbimi, janë të angazhuar në pak shkolla, por në cilësinë e mësime të mësuara të lëndëve përkatëse. Drejtorët e këtyre shkollave kanë autorizuar këta mësime të mësuara vullnetarisht me disa detyra dhe përgjegjësi që lidhen me sigurinë në shkolla dhe parandalimin e dhunës.

Për kundër organizimit të trajnimeve nga institucionet apo OJQ të ndryshme, numri i mësime të mësuara të cilët kanë vijuar trajnime që kanë të bëjnë me temën e studimit, nuk është i kënaqshëm. Prej gjithsej 139 mësime të mësuara të anketuar, vetëm 37.41% nga ta, kanë kryer trajnime përkatëse siç janë *Të drejtat e fëmijëve*, *Trajnime psiko sociale*, *Menaxhimi i konflikteve*, *Diskriminimi*, *Barazia gjinore*, *Trauma*, *shëndeti*, *kujdesi për fëmijët*, *Për trafikimin*.

Aktivitetet jashtëkurrikulare, janë të pranishme në shumicën e shkollave. Kryesisht ato janë ligjërata e debate, aktivitete të ndryshme senzibilisuese me fletëpalosje, postera dhe ekspozita piktore që lidhen me dhunën dhe parandalimin e dhunës. Në disa shkolla vetë mësime të mësuara organizojnë debate të tilla.

Në shkolla nxënësit kontrollohen herë pas herë nga shërbimi i sigurimit, kujdestarët e klasave apo kujdestari i ditës kur dyshohet

se nxënësi mund të ketë me vete armë, mjete tjera të forta apo substanca të palejueshme.

Në disa shkolla ka pasur raste dhune. Rastet më të lehta dhe me pasoja më të vogla janë shqyrtuar brenda shkollës, kurse rastet më të rënda ku ka pasur edhe lëndime apo plagë, janë shqyrtuar me pjesëmarrjen e prindërve të palëve dhe policisë.

Masat që ndërmerren, varen nga shkalla e shkeljes së rregullave shkollore dhe aplikohen në bazë të rregullores, së pari me vërejtje me gojë, pastaj me shkrim, suspendimi prej tri ditësh apo edhe për një priudhë ma të gjatë.

Masa parandaluese për kryerësin e mundshëm që ndërmarrin drejtori, mësimdhënësit apo kujdestari i klasës, janë bisedat, këshillimet, fushata e aktivitete të ndryshme për vetëdijesimin e nxënësve me pasojat e dhunës.

4.2. Rekomandime

Rekomandimet në vijim synojnë të mobilizojnë veprimet e nevojshme në përgjigje ndaj dhunës. Këto rekomandime u adresohen palëve të interesuara dhe kanë për qëllim parandalimin e dhunës dhe krijimin e një ambienti të sigurt për nxënësit dhe mësimdhënësit.

- Krijimi i kushteve për kultivim të kulturës së debatit ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve;
- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit të shkollës, nxënësve dhe prindërve, në lidhje me dhunën, format e dhunës, mënyrën e reagimit dhe masat për parandalimin e saj;

- Zhvillimi i një programi unik të masave për parandalimin dhe zhdjekjen e dhunës në mesin e nxënësve i cili do të përfshijë punën me ushtruesit e dhunës dhe viktimat dhe i cili do të përfshihet në kurrikulë;
- Zhvillimi i një plani kombëtar multisektorial të veprimit për parandalimin e dhunës i cili duhet të përfshijë objektivat, prioritetet, strategjitë, përgjegjësitë dhe mekanizmat e vlerësimit;
- Përshtatja e përmbajtjes mësimore mjedisit shoqëror përmes së cilës do të arrihej ngritja e vetëdijes së nxënësve për vendin dhe rolin e tyre në zhvillimin e shoqërisë e shkolla do të shndërrohet në një institucion të fuqishëm arsimor;
- Prodhimi dhe shpërndarja e materialeve të shtypura dhe të tjera për nxënësit, prindërit, personelin arsimor dhe subjektet tjera veprimtaria e të cilëve direkt ose indirekt lidhet me nxënësit, dhe i referohet parandalimit të dhunës dhe të inkurajimit në zgjidhjen jo të dhunshme të konflikteve në mes tyre;
- Vendosija e bashkëpunimit më të mirë ndërmjet shkollave dhe prindërve me qëllim përfshirjen e prindërve në një masë më të madhe në zgjidhjen e problemeve;
- Përfshirja e bashkësisë së gjerë në zgjidhjen e problemit pranë shkollave dhe familjeve duke përfshirë këtu edhe institucionet relevante si MASHT-in, autoritetet lokale, Policinë, Gjykatat, qendrat për punë sociale, mediat, etj.;
- Organizimi i aktiviteteve jashtë shkollore të tilla si garat sportive, shfaqje kulturore dhe artistike me qëllim të

promovimit të vlerave pozitive të tilla si zhvillimi i miqësisë dhe shoqërisë të cilat mund të organizohen në nivel lokal, rajonal dhe në nivel vendi si gara individuale apo ekipore;

- Bashkëpunimi i shkollave me mediat në përgatitjen e programeve, spoteve televizive e materialeve tjera me qëllim promovimin e të drejtave të njeriut, tolerancës dhe zgjidhjes së konflikteve pa dhunë;
- Formimi dhe funksionalizimi i Ekipeve apo Këshillave të Sigurisë të cilat do të identifikonin rreziqet dhe dhunën në shkollë dhe do të hartonin planin e veprimit për siguri;
- Angazhimi i shërbimit profesional në shkolla;
- Instalimi i kamerave për vëzhgimin e sjellejeve të nxënësve në hapësirat e shkollës dhe angazhimi i shërbimit të sigurimit;
- Kthimi i orëve të kujdestarisë në plan-programet shkollore;
- Mbyllja e kafeneve në afërsi të shkollave.

Bibliografia

1. Allen J. J. Anderson & C. A. General Aggression Model. Marrë nga <http://public.psych.iastate.edu/caa/abstracts/2015-2019/15AA.pdf> 10.09. 2015.
2. Anderson C. A. & Bushman B. J. (2002). Annual Reviews. Psychological,
3. Bushman, B. J., & Huesmann, L. R. (2010). Aggression. In *Handbook of Social Psychology* (5th ed., Vol. 2, pp. 833–863). Hoboken, NJ: John Wiley & Sons Inc. Marrë nga <http://search.proquest.com.proxy.lib.iastate.edu/docview/622138255/A1E0C40520564C2>
4. DeWall, C. N., Anderson, C. A., & Bushman, B. J. (2012). Aggression. In H. Tennen, J. Suls, & I. B. Weiner, (Eds.), *Handbook of psychology* (2nd ed., Vol. 5, pp. 449–466). Hoboken, NJ, US: John Wiley & Sons Inc. Marrë nga <http://search.proquest.com.proxy.lib.iastate.edu/psycinfo/docview/1267038814/80B067D>
5. Fjalor i GjSSH, (1981), Rilindja, Prishtinë.
6. FIQ, USAID, ATRC, (2007), Siguria në shkolla Sfidë për komunitetin, Korrik
7. KEC - UNICEF (2012), Raport për gjendjen e konstatuar në shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në komunën e Klinës, Prishtinë
8. KEC - UNICEF, (2009) Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane/miqësore në shoqëri dhe shkolla, Prishtinë

9. Krahé, B. (2013). *The social psychology of aggression* (2nd ed.). New York, NY: Psychology, Press.
10. MASHT, (2004), Ligji i Inspeksionit të Arsimit, Nr.2004/37
11. MASHT, (2011), Ligji për arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-032;
12. MASHT, (2008), Ligji Nr, 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Prishtinë.
13. MASHT –UNICEF, (2005). Studim
14. Olweus, D. (1998.) Nasilje među djecom u školi: Što znamo i što možemo učiniti. Zagreb: Školska knjiga.
15. Potera, I., Devetaku. G. H., Mehmeti, S., Shala, B. L. (2012). Dhuna verbale ndaj nxënësve – hulumtim mbi fyerjet e nxënësve, Prishtinë): IPK
16. Programi i doktoraturës i kandidatës Mr.sc. Vlora Sylaj “Bashkëpunimi shkollë familje në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve në shkollë Doktoratura-Vlora-Sylaj-Fakulteti-i-Shkencave-Sociale-Departamenti-i-Psikologji-Pedagogjise, 2015
17. Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar, Nr. 21/2013
18. Rexha K. S. & Cakolli M., (2015). Parandalimi i dhunës në shkolla dhe delukucencës së të miturve, Policia e Kosovës,
19. Sokač, A. (2014, prosinac) Čimbenici koji utječu na rizično ponašanje djece i mladih, *EdBi*, (1), 117-124. Marrë nga: <http://www.hbd-sbc.hr/educatio-biologiae/>
20. Strategjia për sigurinë në shkolla 2009 – 2011, “*Shkollat – një vend i sigurt!*”

21. UA NR. 40/2005 Për ndalimin dhe ndërprerjen e punës dhe inicimin e procedurës disiplinore ndaj mësimeve dhe punëtorëve të tjerë në institucionet edukative-arsimore, aftësuese dhe shkencore
22. Udhëzimi administrativ, Nr. 06/2014, - Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta.
23. UNDP – USAID – Pulsi Publik, (2015), Dokument për veprim në lidhje me sigurinë në shkollat e komunës së Prishtinës, (dokument bazë për hartimin e platformës së Komunës së Prishtinës për siguri në shkollë 2015-2018)
24. UNDP – USAID – Pulsi Publik, (2013), Dokument për veprim në lidhje me sigurinë në shkollat e komunës së Prizrenit, (dokument bazë për hartimin e platformës për sigurinë në shkollë)
25. World Health Organization (2002). World report on violence and health, Geneva.

Shtojca

1. Pyetësi për nxënës

Instituti Pedagogjik i Kosovës është duke realizuar hulumtimin: “*Siguria në shkolla*”. Përgjigjet e juaja në pyetësor do të mundësojnë informimin për gjendjen aktuale të sigurisë në shkolla dhe nxjerrjen e rekomandimeve për MASHT dhe institucionet tjera relevante për shkolla të sigurt.

Ju lusim që në pyetjet e parashtuara në pyetësor, të përgjigjeni në mënyrë të sinqertë. Informacioni që ju do të jepni, mbetet anonim dhe do të përdoret vetëm për arsye hulumtimi.

Udhëzim: Pyetësorin e plotësoni duke rrethuar, vendosur shenjat **✓** ose **X**, apo duke plotësuar zbrazëtirat

1. Tipi i shkollës së mesme ku ju vijoni mësimet

Gjimnaz Shkollë profesionale

2. Gjinia: M F

3. Klasa: _____

4. Sa jeni të informuar për bazën ligjore të sigurisë në shkolla (Ligjet, Strategjitë, Rregulloret e shkollës, Kodin e mirësjelljes, etj.)?

- a) Shumë mirë
- b) Mirë
- c) Pak
- d) Aspak

5. Sa ndjeheni të sigurt?

		Shumë të sigurt	Të sigurt	Të pasigurt	Shumë të pasigurt
1	Gjatë shkuarjes në shkollë				
2	Në shkollë				
3	Gjatë kthimit në shtëpi				

6. Nga çka jeni të rrezikuar gjatë udhëtimit për në shkollë?

		Çdo herë	Shpesh	Nganjëherë	Kurrë
1	Ngacmimet nga njerëzit (bandat, huliganët)				
2	Qentë endacak				
3	Mjetet e komunikacionit				
4	Mungesa e ndriçimit në rrugë				
5	Tjetër _____				

7. Specifikoni shpeshësinë e ngacmimit gjatë periudhave të mëposhtme. (Jepni nga një përgjigje për secilën deklaratë.)

		Çdo herë	Shpesh	Nganjëherë	Kurrë
1	Para mësimt				
2	Gjatë orëve të mësimt				
3	Gjatë pauzave (orëve të lira, drekës, etj.)				
4	Gjatë aktiviteteve shkollore				
5	Pas mësimt				

8. Në cilat hapësira brenda shkollës ndodhin incidente?

		Çdo herë	Shpesh	Nganjëherë	Kurrë
1	Në hyrje dhe dalje të shkollës				
2	Në klasë të zbrazët				
3	Në shkallë				
4	Në korridor				
5	Në laborator				

6	Në fushën e sportit				
7	Në tualet (WC)				
8	Në oborr				
9	Në bufe të shkollës				
10	Tjetër, (shëno) _____				

9. Që nga fillimi i vitit shkollor, sa herë në shkollë keni hasur në vështirësitë në vijim?

		Kurrë	Një apo dy herë gjatë vitit	Një apo dy herë gjatë muajit	Një apo dy herë gjatë javës	Çdo ditë
1	Ju ka shtyrë dhe penguar ndokush					
2	Ju ka sulmuar fizikisht (godit me shuplakë, grushte ose shkelma)					
3	Ju ka kërcënuar dikush se do të ju lëndoj në qoftë se ju nuk i jepni atij diçka që është e juaja (p. sh. para, telefon celular, iPod, veshje, etj).					
4	Ju ka prekur apo ngacmuar seksualisht.					
5	Ju ka detyruar dikush i që të bëni diçka kundër vullnetit tuaj.					
6	Ka bërë thashetheme për ju					
7	Qeshet me ju dhe ju					

	drejtohet me emra fyes					
8	Dikush ka shpërndarë për të tjerët për mes telefonit apo internetit informacione apo foto qe ju lëndojnë juve					
9	Dikush ka thyer qëllimisht apo dëmtuar diçka që u takon juve					

10. Gjatë vitit të fundit a keni bërë këto gjëra ndaj ndokujt në shkollën tuaj?

		Kurrë	Një apo dy herë gjatë vitit	Një apo dy herë gjatë muajit	Një apo dy herë gjatë javës	Çdo ditë
1	Keni shtyrë apo penguar ndokënd					
2	Keni sulmuar fizikisht (godit me shuplakë, grushte ose shkelma) ndokënd					
3	Keni kërcënuar ndokënd se do ta lëndoni në qoftë se nuk u jep diçka që është e tij (p. sh. para, telefon celular, iPod, veshje, etj).					
4	Keni prekur apo ngacmuar ndokënd seksualisht.					

5	Keni detyruar ndokënd që të bëjë diçka kundër vullnetit të tij					
6	Keni bërë thashetheme për të tjerët					
7	Jeni tallur me ndokënd dhe i jeni drejtuari me emra fyes					
8	Keni shpërndarë informacionet apo fotot e ndokujt për mes telefonit apo internetit					
9	Keni thyer apo dëmtuar qëllimisht gjërat e ndokujt					

11. A mendoni se tash ka më shumë dhunë se sa vitet e kaluara?

- a) Më shumë
- b) Më pak
- c) Njësoj

12. Nga kush jeni të rrezikuar?

- a) Huliganët
- b) Nxënësit e shkollave tjera
- c) Nxënësit më të rritur
- d) Moshatarët
- e) Tjetër, (specifiko)
-

13. Më shumë rrezikoheni nga djemtë apo vajzat?

- a) Djemtë
- b) Vajzat

14. Ndaj kujt ushtrohet më tepër dhuna/kërcënimi/ngacmimi?

- a) Djemve
b) Vajzave

15. A keni vërejtur se në shkollën tuaj nxënësit bartin me vete?

		Kurrë	Një apo dy herë gjatë vitit	Një apo dy herë gjatë muajit	Një apo dy herë gjatë javës	Çdo ditë
1	Armë të ftohta					
2	Armë të zjarrit					
3	Drogë					
4	Alkool					
5	Duhan					

16. A keni pasur rastin të shihni kur ndonjë nxënës ka qenë viktimë e dhunës? Si keni reaguar?

Po

Jo

Nëse po, si ke reaguar? (rretho të gjitha përgjigjet që janë të sakta në rastin tuaj)

- a) Nuk kam bërë asgjë **(nëse s`keni bërë asgjë, kaloni në pyetjen 17)**
b) I kam treguar mësimdhënësit.....
c) I kam treguar drejtorit/zëvendësdrejtorit.....
d) I kam ndihmuar viktimës në momentin e incidentit
e) I kam ndihmuar viktimës pas incidentit
f) Kam thirrur policinë.....
g) Kam kërkuar ndihmë për ta ndaluar
h) Vetëm kam shikuar
i) Tjetër, (specifiko)

17. Nëse s`keni bërë asgjë, pse? (rretho të gjitha përgjigjet që janë të sakta në rastin tuaj)

- a) Kam pasur frikë
 - b) Nuk e dija kujt t`i tregoj dhe çka të bëjë
 - c) Kam menduar se edhe po t`i tregoja dikujt,
kjo nuk do të ndihmonte asgjë
 - d) Kam menduar se po e keqësoj situatën
 - e) Kam menduar se po të ndihmoja viktimën,
do të pësoja vetë
 - f) Nuk kam dashur të futem në telashe
 - g) Tjetër, (specifiko)
-

18. A keni qenë ju viktimë e dhunës/kërcënimit/ngacmimit?

Po

Jo

Nëse po, si keni reaguar ? (rretho të gjitha përgjigjet që janë të sakta në rastin tuaj)

- a) Nuk kam bërë asgjë (**nëse s`keni bërë asgjë, kaloni në pyetjen 19**)
- b) U kam treguar prindërve të mijë
- c) I kam treguar vëllait ose motrës
- d) I kam treguar kujdestarit të klasës
- e) I kam treguar drejtorit/zëvendësdrejtorit
- f) U kam treguar mësimdhënësve
- g) Kam thirrur policinë
- h) Jam mbrojtur.....
- i) Kam kërkuar ndihmë nga të tjerët për ta ndalur
dhunën

- j) Jam hakmarrë më vonë
- k) Tjetër, (specifiko) _____

19. Nëse s`keni bërë asgjë, pse? (rretho të gjitha përgjigjet që janë të sakta në rastin tuaj)

- a) Kam pasur frikë
- b) Nuk e dija kujt t`i tregoj dhe çka të bëjë
- c) Kam menduar se edhe po t`i tregoja dikujt, kjo nuk do të ndihmonte asgjë
- d) Nuk kam dashur të tregoja
- e) Nuk kam dashur të futem në telashe tjera
- f) Frikësohesha se po e keqësoj situatën
- g) Tjetër, (specifiko)
- _____

20. Nëse keni qenë viktimë e dhunës apo kërcënimit a ju është dashur të qëndroni në shtëpi dhe të mungoni nga shkolla?

Po

Jo

21. Juve personalisht ju ka ndodhur që:

		Po	Jo
1	Shkolla juaj ka thirr prindërit e juaj për problemet që keni shkaktuar në shkollë		
2	Të jeni suspenduar nga shkolla juaj		
3	Që të jetë ftuar policia për problemet që keni shkaktuar në shkollë?		
4	Të jeni akuzuar apo arrestuar nga policia		

22. Sipas jush, sa drejtori, zëvendës drejtori, mësimdhënësit dhe shërbimi profesional merren me sigurinë në shkollë:

		Çdo herë	Shpesh	Nganjëherë	Asnjëherë
1	Njoftojnë për dhunën/kërcënimin				
2	Përpiqen të ndalojnë dhunën/kërcënimin				
3	Injorojnë aktet e dhunës/kërcënimit				
4	Flasin hapur për dhunën/kërcënimin				
5	Arsyetojnë ata që i bëjnë këto kërcënime				
6	Mbështesin dhe mbrojnë viktimat				
7	Dënojnë ata që dhunojnë/ngacmojnë të tjerët				
8	Dëgjojnë të dy palët				

23. A është e pranishme policia në afërsi të shkollës?

- a) Rregullisht (Çdo herë)
- b) Herë pas herë
- c) Sipas nevoje (me kërkesë të shkollës)
- d) Asnjëherë

24. A duhet të ketë polici në shkollë?

Po

Jo

Nëse po, si duhet të organizohet prania e saj?

- a) Vendorsje e policisë së përhershme në shkollë
- b) Përmes vizitave (patrullimeve)
- c) Përmes ligjëratave edukative
- d) Përmes policëve civilë
- e) Vetëm kur ka incidente
- f) Nuk e di

25. Çfarë mund të bëni ju nxënësit, që shkolla juaj të bëhet më e sigurt?

26. Çfarë mund të bëjnë mësuesit, që shkolla juaj të bëhet më e sigurt?

27. Vërejtje, komente, sugjerime:

Faleminderit për bashkëpunimin!

2. Pyetësi për mësimdhënës

Instituti Pedagogjik i Kosovës është duke realizuar hulumtimin: „*Siguria në shkolla*“. Përgjigjet e juaja në pyetësor do të mundësojnë informimin për gjendjen aktuale të sigurisë në shkolla dhe nxjerrjen e rekomandimeve për MASHT dhe institucionet tjera relevante për shkolla të sigurta.

Ju lusim që në pyetjet e parashtruara në pyetësor, të përgjigjeni në mënyrë të sinqertë. Informacioni që ju do të jepni mbetet anonim dhe do të përdoret vetëm për arsye hulumtimi.

Udhëzim: Pyetësin e plotësoni duke rrethuar, vendosur shenjat **✓** ose **X**, apo duke plotësuar zbrazëtirat.

Shkolla: ----- **Vendi:** -----

1. **Gjinia:** a) Femër b) Mashkull

2. **Mësimdhënës i lëndës:**

3. **Përgatitja shkollore:**

a) Fakultet Drejtimi: _____

b) Master Drejtimi: _____

c) Tjetër _____

4. **Mosha (vjeç)**

a) 21-30 b) 31-40 c) 41-50

d) 51-60 e) Mbi 60

5. **Përvoja e punës në arsim (sa vite)**

- a) 1-5 b) 6-10 c) 11-15 d) 16-20
e) 21-25 f) 26-30 g) Mbi 30

6. Keni ndjekur trajnime për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në shkolla:

- a) Të drejtat e fëmijëve
b) Trajnime psiko sociale
c) Menaxhimi i konflikteve
d) Tjetër (shëno) _____

7. Sa jeni te informuar për bazën ligjore të sigurisë në shkolla (Ligjet, Strategjitë, Rregulloret brenda shkollave etj.)?

- e) Shumë mirë
f) Mirë
g) Pak
h) Aspak

8. Komenti juaj për bazën ligjore që rregullon sigurinë në shkolla:

9. Rregulloret e shkollës zbatohen në shkollën tuaj:

- a) Plotësisht
b) Pjesërisht
c) Aspak

10. Sipas mendimit tuaj sa janë të sigurt nxënësit në shkollë?

- a) Shumë të sigurt
b) Të sigurt
c) Të pa sigurt
d) Shumë të pasigurt.

11. Dhuna dhe kërcënimet/ngacmimet/rreziqet për nxënësit gjatë udhëtimit për në shkollë:

		Çdo herë	Shpesh	Nganjëherë	Kurrë
1	Ngacmimet nga njerëzit (bandat, huliganët)				
2	Qentë endacakë				
3	Mjetet e komunikacionit				
4	Mungesa e ndriçimit në rrugë				
5	Tjetër, (shëno) _____				

12. Sipas mendimit tuaj nxënësit më shumë rrezikohen:

		Çdo herë	Shpesh	Nganjëherë	Kurrë
1	Gjatë shkuarjes në shkollë				
2	Gjatë orëve të mësimit				
3	Gjatë pauzave (orëve të lira, drekës, etj.)				
4	Gjatë aktiviteteve shkollore				
5	Pas mësimit				

13. Nga përvoja juaj në mësimdhënie, incidentet ndodhin më shumë:

		Çdo herë	Shpesh	Nganjëherë	Kurrë

1	Në hyrje dhe dalje të shkollës				
2	Në klasë të zbrazët				
3	Në shkallë				
4	Në korridor				
5	Në laborator				
6	Në fushën e sportit				
7	Në tualet (WC)				
8	Në oborr				
9	Në bufe të shkollës				
10	Tjetër, (shëno) _____				

14. A ju ka ndodhur që nxënësit e shkollës suaj bartin me vete?

	Kurrë	Një apo dy herë gjatë vitit	Një apo dy herë gjatë muajit	Një apo dy herë gjatë javës	Çdo ditë
1	Armë të ftohta				
2	Armë të zjarrit				
3	Drogë				
4	Alkool				
5	Duhan				

15. Sa prej nxënësve raportojnë mbi mbajtjen e armëve dhe substancave në shkollë?

	Asnjë	Fare pak	Disa	Shumica
1	Armë zjarri			
2	Armë të ftohta			
3	Drogë			
4	Alkool			
5	Duhan			

16. Sipas mendimit tuaj, sa është e lehtë gjetja e armëve ne shkollën tuaj?

		Shumë e vështirë	E vështirë	E lehtë	Shumë e lehtë
1	Armë të ftohta				
2	Armë të zjarrit				
3	Drogë				
4	Alkool				
5	Duhan				

17. A ka ndodhur në shkollën tuaj që si pasoje e dhunës ne shkollë:

		Po	Jo	Nuk e di
1	Nxënësi është përjashtuar			
2	Nxënësi është përjashtuar për kohësisht			
3	Nxënësi ka ofenduar mësimitdhënësin			
4	Nxënësi ka goditur mësimitdhënësin			
5	Mësimitdhënësi ka ofenduar nxënësin			
6	Mësimitdhënësi ka rrahur nxënësin			

18. A ekziston ndonjë shërbim profesional në shkollën tuaj që merret me këtë problematikë?

Po

Jo

Nëse po, specifiko

19. A bashkëpunon shkolla juaj me mjekë, psikologë dhe specialistë tjerë, për nxënësit që kanë nevojë për mbështetje shtesë?

- a) Çdo herë
- b) Nganjëherë
- c) Sipas nevojës
- d) Asnjëherë

20. Sa jeni të kënaqur me bashkëpunimin me prindër lidhur me sigurinë në shkollë ?

- a) Shumë
- b) Pak
- c) Aspak

21. Sa informoheni ju nga prindërit e nxënësve për përjetimin e dhunës dhe ngacmimeve në shkollë?

- a) Gjithmonë
- b) Shpesh
- c) Nganjëherë
- d) Rrallë
- e) Asnjëherë

22. Sa ju i informoni prindërit për përjetimin e dhunës dhe ngacmimeve në shkollë?

- a) Gjithmonë
- b) Shpesh
- c) Nganjëherë
- d) Rrallë
- e) Asnjëherë

23. A keni bashkëpunim me policinë rreth problematikës në fjalë?

- a) Rregullisht
- b) Herë pas herë
- c) Sipas nevoje (me kërkesë të shkollës)
- d) Asnjëherë

24. A duhet të ketë polici në shkolla?

Po

Jo

Nëse po, si duhet të organizohet prania e saj?

- g) Vendosije e policisë së përhershme në shkollë
- h) Përmes vizitave (patrullimeve)
- i) Përmes ligjëratave edukative
- j) Përmes policëve civilë
- k) Vetëm kur ka incidente
- l) Nuk e di

25. Çfarë mund të bëjnë nxënësit që shkolla juaj të bëhet më e sigurt?

26. Çfarë mund të bëni ju që shkolla juaj të bëhet më e sigurt?

27. Vërejtje, komente, sugjerime:

Faleminderit për bashkëpunimin!

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi

Shtypshkronja NTSH “Rilindja” Prishtinë

Tirazhi: 500 copë

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

316.485.2-053.5(496.51)(048.83)

37.011(496.51)

Mekolli, Skender

Dhuna dhe siguria në shkolla - raport hulumtimi /
Skender Mekolli. - Prishtinë: Instituti Pedagogjik i
Kosovës, 2015. - 100 f.: ilustr. me ngjyra; 21 cm.

Literatura: f. 80-82

ISBN 978-9951-591-24-9

ISBN 978-9951-591-24-9



9

789951

591249